BPRG Balkans Policy Research Group

KOSOVA 2020: Agjenda Sfiduese për Qeverinë e Re

Dhjetor 2019

Balkans Policy Research Group

KOSOVA 2020: AGJENDA SFIDUESE PËR QEVERINË E RE

Deklaratë mohimi:
Pikëpamjet dhe analizat në këtë raport janë vetëm të Grupit për Ballkan dhe nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve.

Autor: Grupi për Hulumtim të Politikave në Ballkan (BPRG)

Norwegian Embassy

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
PRIORITETET QEVERITARE	5
MADHËSIA DHE STRUKTURA E KABINETIT	6
ADMINISTRATA PUBLIKE	7
ERA DHE MSA	10
DIALOGU ME SERBINË	13
POLITIKA E JASHTME	16
DREJTËSIA	21
ARSIMI	25
SHËNDETËSIA	28
MJEDISI	31
EKOMOMIA DHE ZHVILLIMI	36

HYRJE

Më 6 tetor kosovarët dolën në zgjedhje të reja, për herë të tretë në pesë vitet e fundit.[1] Në këto zgjedhje garuan njëzet e pesë parti, 7 prej të cilave nga radhët e shumicës shqiptare, 4 e përfaqësuan komunitetin serb, ndërkohë që të tjerat kandiduan për vendet e rezervuara për komunitetet e tjera joshumicë. Rezultatet shënuan një ndryshim në politikën kosovare. Vetëvendosja fitoi zgjedhjet me 29 ulëse të siguruara, duke bërë kështu që kryetari i saj, Albin Kurtin, të bëhet kandidati kryesor për kryeministër të qeverisë së re. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) doli e dyta, me 28 ulëse. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) mori 24 dhe pas 12 vjetësh në pushtet, tani planifikon të ulet në opozitë. As ish-partnerët e saj në qeveri nuk kaluan më mirë; Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e ish-kryeministrit Haradinaj siguroi vetëm 13 ulëse, duke mos ia lënë asnjë partnerit të saj të koalicionit, Partisë Socialdemokrate të Kosovës (PSD), një parti kjo e ndarë nga Vetëvendosja që udhëhiqet nga Shpend Ahmeti. Koalicioni i përbërë nga NISMA dhe Aleanca Kosova e Re (AKR) mezi e kaloi pragun, duke siguruar 6 ulëse (përkatësisht, 4 dhe 2). [2]



Qeveria Haradinaj, e themeluar në shtator të vitit 2017, përbëhej nga 4 parti të mëdha – ndër më kryesoret - dhe nga një mori partish të vogla që i përfaqësonin serbët dhe pakicat e tjera.[3] Si rrjedhojë qeverisë i mungonte kohezioni, u krijua një kabinet mostruoz, ndërkohë që drejtuesit e institucioneve nuk arrinin që të koordinoheshin.[4] Sikurse edhe shumica e qeverive gjatë dekadës së fundit, edhe kjo shtyu përpara nisma që rridhnin nga proceset integruese evropiane ose që kërkoheshin nga partnerët ndërkombëtarë, e të cilat me vete sollën edhe kontradikta e polemika. Nga ana tjetër, qeveria prodhoi fare pak nisma të veta, dështoi të përmirësonte qeverisjen e vendit, por edhe gjendjen politike, sociale dhe ekonomike.

Gjatë këtij gjysëm-mandati, Kuvendi miratoi 109 ligje, 26 prej të cilëve kanë të bëjnë me ratifikimin e instrumenteve të marrëveshjeve të ndryshme ndërkombëtare (8 me Bashkimin Evropian, 1 shumëpalëshe

[1] Më 19 korrik, kryeministri Ramush Haradinaj dha dorëheqje, pasi që u ftua në Hagë për t'u marrë në pyetje nga ana e Zyrës së Prokurorisë Speciale. Ky veprim e përfundoi para kohe qeverisjen e tij dhe të të ashtuquajturit koalicioni PAN, më pak se dy vite pas formimit. Meqë nuk pati asnjë kandidat alternativ, Kuvendi votoi shpërbërjen e tij më 22 gusht, ndërkaq presidenti i Republikës i shpalli zgjedhjet e parakohshme, të cilat u mbajtën më 6 tetor 2019.

[2] Për më shumë informata rreth rezultatit të zgjedhjeve dhe rrugës përpara, shih Grupit për Ballkan, *[Kosova 2019: Shmangia e krizës paszgjedhore - Rrugëtimi nga certifikimi deri tek inaugurimi,* nëntor 2019, në https://balkansgroup.org/blog/post/kosovo-19-avoiding-post-electoral-crisis-roadmap-certification-inauguration

[3] Për më shumë informata mbi Qeverinë Haradinaj shih Grupit për Ballkan, *Edhe një rrezik i madh për Kosovën: Qeveria Haradinaj sfidon agjendën, [Another High Stake for Kosovo: Haradinaj's Government Challenging Agenda]*, shtator 2017, dhe Grupit për Ballkan, *Edhe 100 ditë të Ramush Haradunajt,* dhjetor 2017

[4] Si burim i dështimit të një numri të madh të politikave publike, të dy burimet, ato vendore dhe organizatat ndërkombëtare vazhdimisht kanë vënë në pah mungesën e koordinimit brenda qeverisë, e nganjëherë edhe brenda vetë departamenteve. Për një pasqyrë gjithpërfshirëse, shih Komisioni Evropian, *Kosovo* 2019 Report*, SWD(2019) 216 final, Strasburg, 29 maj 2019, f. 10. Për efektet e tij në çështjet sektoriale, shih Kosovar Institute for Policy Research and Development, *Gender Analysis of the National Program for the Implementation of the Stabilization and Association Agreement 2017-2021 and 2018-2022*, tetor 2019, f. 24 dhe Instituti Prishtina për Studime Politike, *A Critical Revieë of the Organization and Implementation of Kosovo's Foreign Policy*, 2018, f. 20

dhe 17 dypalëshe me vende evropiane ose me institucione financiare).[5] Pjesa tjetër trajton një gamë të gjerë çështjesh, që nga struktura e gjyqësorit e deri te ligji për korporata dhe taksa; shumica e të cilave burojnë nga Agjenda për Reforma Evropiane (ERA). [6]

Me shpërbërjen e Kuvendit, rreth 50 projektligje të cilët ende ishin në shqyrtim u shndërruan në "punë të papërfunduara", dhe ato tani duhet të riprocedohen nga e para. Rishikimi Funksional i Sektorit të Sundimit të Ligjit dhe Drejtësia 2020 do të vazhdojnë edhe nën qeverinë e re, kështu që brenda një të ardhmeje të afërt pritet të ndodh një aktivitet i mëtutjeshëm legjislativ.[7] Qeveria në largim ka përparuar negociatat me BE për ERA II; në prill 2019, ishte prezantuar një draft i avancuar për konsultime më të gjera me akterë të tjerë. Mirëpo, lancimi i saj mbeti peng i mosmarrëveshjeve ndërmjet BE-së dhe Qeverisë së Kosovës.[8] Ka të ngjarë, që ERA II të lancohet menjëherë pas marrjes së detyrës nga qeveria e re, kështu që kjo do të kërkojë një kombinim të ri të veprimeve legjislative dhe të iniciativave, në mënyrë që faza e parë e procesit të reformave të ndërtohet dhe zbatohet plotësisht. [9]

Hapësira e manovrimit për qeverinë e re do të jetë e kufizuar nga realiteti socio-ekonomik, administrata joefikase me mungesë të mëdha fondesh dhe me një sistem jofunksional partiak, poashtu dhe nga nevoja e ecjes drejt proceseve të ndryshme të sponsoruara nga ndërkombëtarët. Të gjitha këto, brenda një peizazhi të vështirë politik. Përkundër faktit se zgjedhjet u zhvilluan në mënyrë të rregullt dhe pa incidente, raportet ndërmjet partive politike mbesin të tensionuara.[10] Edhe pse mandati i kaluar ishte dukshëm më i qetë se sa periudha 2014-2017, koalicioni qeverisës i udhëhequr nga Ramush Haradinaj ishte i paaftë që të arrinte konsensus me opozitën, kështu që Marrëveshja përçarëse e Demarkacionit të Kufirit vetëm sa e rikonfirmoi papjekurinë demokratike të partive politike kosovare.[11] Po ashtu, anëtarët e koalicionit qeverisës kishin raporte të vështira edhe në mes veti; kryeministri Haradinaj pati mardhënie të tensionuara me presidentin Hashim Thaçi, por edhe me kreun e Kuvendit dhe kryetarin e PDK-së, respektivisht të partisë më të madhe të kolaicionit, Kadri Veselin.

---

[5] Këto marrëveshje ndërkomëbtare përfshijnë edhe Marrëveshjen e turpshme të Demarkacionit të Kufirit me Malin e Zi, e cila doli të jetë përçarëse për Qeverinë Mustafa. Gjithashtu, këtu përfshihet edhe Ratifikimi i Marrëveshjeve për Instrumentin e Para-anëtarësimit, ndërmjet Kosovës dhe B E-së, për periudhën 2016-2018. Lista e plotë mund të shqyrtohet (në shqip) në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Evindenca Ligjeve, 4 shtator 2019, në http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Evidencaeligjeve_upXpvBN35N.pdf

[6] Këtu përfshihet një numër ligjesh që e rregullojnë sistemin juridik, si Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (dhjetor 2018), Ligji për Noterinë (dhjetor 2018), Kodi Penal (janar 2019) dhe Ligji për Këshillin Prokuorial të Kosovës (prill 2019).

[7] Disa raporte që datojnë nga periudha e para zgjedhjeve e kanë cilësuar performancën e Kuvendit si më të dobtën që nga themelimi. Instituti Demokratik i Kosovës vëren se 4/5 e agjendës legjislative mbetën të paprekura deri në kohën e shpërbërjes së Kuvendit. Për më tepër shih Pristina Insight, *Kuvendi i ri, problemet e vjetra, thonë deputetët,* [*New Assembly, Old Problems, MPs Warn*], 19 gusht 2019, në https://prishtinainsight.com/new-assembly-old-problems-mps-warn/

[8] Bashkimi Evropian refuzoi lancimin e ERA-s për shkak të mospajtimeve me qeverinë e Kosovës në lidhje me tarifat qe kjo e fundit vendosi ndaj mallrave që vijnë nga Serbia dhe Bosnia e Hercegovina. Intervistë e Grupit për Ballkan me zyrtarët e Zyrës së BE-së në Kosovë dhe qeverisë së Kosovës, maj 2019.

[9] Për më shumë informata rreth ERA I shih raportin e Grupit për Ballkanin, *Agjenda për Reformat Evropiane: Qeverisja e mirë dhe Sundimi i Ligjit, Raporti i Progresit,* tetor 2017

[10] Administrimi i zgjedhjeve është përmirësuar vazhdimisht gjatë dekadës së fundit. Zgjedhjet e parakohshme më 2019 ishin të administruara mirë, dhe ato u pasuan nga disa fushata që u përshkruan si "kumbuese", dhe që u mbajtën pa incidente të mëdha. Megjithatë, zonat e banuara me serbë mbesin pika të zeza, ku përkrahësit e Listës hegjemoniste Serbe që sponzorohet nga Beogradi ushtrojnë presion të padrejtë ndaj cilësdo opozitë. Për më shumë informata shih Misioni i Bashkimit Evropian për Monitorimin e Zgjedhjeve në Kosovë* 2019, KUMTES PRELIMINIARE: Zgjedhje të administruara mirë dhe transparente të ndikauara nga kushtet e parabarta në terren, por edhe nga njollosura për shkak të frikësimit dhe mungesës së konkurrencës në zonat serbe të Kosovës [PRELIMINARY STATEMENT: Well-administered and transparent elections affected by an uneven playing field, and marred by intimidation and lack of competition in the Kosovo Serb areas], 8 tetor 2019, në https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/ps_final_version.pdf

[11] Në mars 2018, një seancë plenare e Kuvendit që synonte ta ratifikonte marrëveshjen u desh të suspendohej, kur Vetëvendosje, asokohe në opozitë, sërish vendosi të hidhte kanaqe me gaz lotsjellës brenda sallës.

Në një moment, raportet ndërmjet tyre u prishën deri në atë masë saqë refuzonin edhe të flisnin me njëri-tjetrin, apo e akuzonin njëri-tjetrin për minimin e pozicionit të tyre. [12]

Vetëvendosje dhe LDK bënë opozitë të fuqishme ndaj Haradinajt dhe jo aq bashkëpunuese; edhe nëse i bashkojnë forcat në pushtet ata do të përballen me të njëjtin trajtim nga ajo që ka mbetur prej koalicionit PAN.[13] AAK-ja e Haradinajt, në veçanti, do ta mbrojë fuqishëm tarifën e vendosur ndaj mallërave të Serbisë – po qe se qeveria e Kurtit synon ta largojë atë.[14] Kurti e ka bërë tashmë të qartë se tarifat nuk ishin inicativë e tij.[15] Nga ana tjetër, PDK, si partia më e madhe opozitare, do të jetë një partner sfidues për qeverinë e re. Mardhëniet e vazhdueshmte të tensionura, niveli i lartë i mosbesimit dhe egot personale ndaj njëri tjetrit, do ta bëjnë të vështirë-nëse jo edhe të pamundur- ndërtimin e raporteve konstruktive mes qeverisë dhe opozitës.

Tutje, edhe vetë mënyra se si qeveria e re do të ndërveprojë me Presidentin Hashim Thaçi dhe me zyrën e tij mbetet e dyshimtë. Deri më tani, presidenti Thaçi ka pasur një rol qendror në politikën kosovare krahasuar me paraardhësit e tij, mbase edhe për shkak të prezencës së vazhdueshme të ish-partisë së tij në qeverit. Mirëpo, në një qeveri të udhëhequr nga Vetëvendosje dhe LDK ndikimi i tij sigurisht do të zbehet. Në të vërtetë, duke marrë parasysh armiqësitë nga e kaluara ka gjasa që fërkimet të vazhdojnë, të paktën deri në përfundimin e mandatit të Thaçit, në fillim të vitit 2021. Nëse shefi i Shtetit dështon të ndërtojë raporte pune me shefin e Qeverisë, një numër i çështjeve do të rrezikojnë të bllokohen, përfshirë këtu Politikën e Jashtme dhe Dialogun me Serbinë. Ngjashëm, edhe emërimet e ndryshme në institucionet e pavarura kushtetuese mund të komplikohen pa nevojë.[16]

Megjithëkëtë, ka shumëçka që qeveria mund të bëjë; ajo duhet të lancojë nisma të reja për përmisimin e sistemit shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, planifikimin e politikave dhe në koordinimin dhe luftimin e ekonomisë joformale dhe korrupsionit.

[12] Distancimi mes presidentit dhe kryeministrit u bë i qartë gjatë dhe pas Samitit të Berlinit, ku ata jo vetëm që aranzhuan transporte të ndara, por edhe manifestuan publikisht mospajtimet e tyre lidhur me Serbinë dhe me tarifat e vendosura nga Qeveria Haradinaj ndaj mallërave serbe.

[13] Koalicioni PAN fitoi në zgjedhjet e vitit 2017, duke marrë 39 ulëse dhe duke u bërë asokohe grupi më i madh politik në Kuvend. Ai mori mbështetjen e AKR-së (e cila kishte garuar në koalicion me LDK), të Lista Srpska's, të disa partive që përfaqësojnë komunitet pakicë dhe të disa deputetëve që e kishin braktisur LDK-në, duke formuar kështu një qeveri me 62 deputetë, dhe koalicionin PANA. Në vitin 2019, anëtarët e këtij kolaicioni garuan veçmas, dhe kaluan edhe më keq individualisht; PDK fitoi 28 ulëse, AAK 13, Nisma-AKR 6.

[14] Intervistë e Grupit për Ballkan me një anëtar të AKK-së, Prishtinë, 21 tetor 2019

[15] Në një intervistë për gazetën britanike The Guardian, Kurti tha se "tarifat e importit prej 100 përqind […] ndaj mallërave serbe do të tërhiqen vetëm nëse do të ketë masa të plota reciproke që e mundësojnë tregtimin e Kosovës në Serbi [dhe në Beograd], si dhe […] e përfundojnë fushatën ndërkombëtare diplomatike për bindjen e shteteve që të tërheqin njohjen e Kosovës". Për më shumë informata shih intervistën e plotë në https://www.theguardian.com/world/2019/oct/21/kosovo-likely-new-leader-albin-kurti-condemns-eu-balkans-policy

[16] Sipas Nenit 84 të Kushtetutës, presidenti udhëheq politikën e jashtme, vendos mbi krijimin e misioneve dioplmatike, emëron ambasadorët, komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, stafin kyç të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, kreun e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës. Megjithëse shumica e këtyre punëve bëhen në konsultim me, apo pas propozimit nga institucionet e tjera, margjina e diskrecionit që ka presidenti në këto çështje nuk është zgjidhur ende me kushtetutë.

PRIORITETET QEVERITARE

Qeveria e re e cila do ta marr detyrën së shpejti, pavarësisht përbërjes së saj, do të trashëgoj një listë të gjatë qështjesh nga paraardhësja e saj. Sistemet jofunksionale të shëndetësisë dhe arsimit, ekonomia joformale e pataksuar, gjyqësësori i ngadaltë dhe shpeshherë i paefektshëm, administrata publike e dobët; të gjitha këto kërkojnë ndërhyrje të mëdha. Dështimi i shërbimeve publike ilustrohet grafikisht me një numër të lartë pacientësh që trajtohen jashtë vendit dhe me regjistrimin e vazhdueshëm të fëmijëve të politikanëve nëpër shkolla private e ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit.[17] Situata paraqitet edhe më e komplikuar kur kihet parasush se raportet ndërmjet akterëve kryesorë politikë mbesin të tensionuara; liderët nuk i besojnë njëri-tjetrit, rrjedhimisht vazhdojnë të mungojnë edhe normat themelore të bashkëpunimit mes akterëve. Kjo vlen në veçanti për liderin e Vetëvendosjes, Albin Kurti, i cili pjesën më të madhe të kohës e ka kaluar në opozitë (e para kësaj, si aktivist) duke sulmuar partitë tjera, përfshirë këtu partnerin potencial aktual, LDK-në.[18]

Në qoftë se Kurti synon të sigurojë postin kryeministrit dhe të udhëheq qeverinë, ai duhet të ndërtojë raporte më të mira me partnerin e tij të koalicionit, por edhe me opozitën, me të cilën nuk u përpoq të pajtohej kurrë. Cilado që të jetë qeveria e re, ajo do të duhet të krijojë një klimë të favorshme për zbatimin e reformave të premtuara. Në rastin e Kurtit, në veçanti, kjo do nënkuptonte një kthesë 180 shkallëshe dhe një angazhim të përbashkët me opozitën që nga dita e parë.

Këto prioritete për qeverinë e re, të radhitura në vazhdim, nuk synojnë që të jenë gjithëpërfshirëse, por të paraqesin një përshkrim të çështjeve të ngutshme me të cilat qeveria do të duhej të merrej, për të siguruar ecjen përpara. Përbërja e qeverisë, zhvillimet e brendshme dhe ato ndërkombëtare mund të ndikojnë po ashtu në përcaktimin e prioriteteve. Mirëpo, këto çështje kërkojnë një trajtim të veçantë, sepse atoparaqesin thelbin e zhvillimit dhe nuk do të zhduken publike brenda një afati të shkurtër.

[17] Mes janarit dhe shtatorit të vitit 2019, 1,063 pacientë kosovarë u trajtuan jashtë vendit, me një çmim prej mbi 10 milionë eurove të buxhetit të vendit. Për më shumë shih Gazeta Blic, *Mbi 500 persona presin për shërim jashtë vendit, mbi 10 milionë euro të shpenzuara,* 4 nëntor 2019, në https://gazetablic.com/mbi-500-persona-presin-per-sherim-jashte-vendit-shpenzohen-mbi-10-milione-euro/. Njëkohësisht, politikanët e profilit të lartë, përfshirë presidentin Thaçi, kryeministrin Haradinaj dhe kryetarin e Kuvendit, Kadr Veseli, i kanë dërguar fëmijët e tyre nëpër shkolla private. Për më shumë shih Zeri, *Politikanët i cojnë fëmijët në shkolla të shtrenjta,* 2 shtator 2019, në https://zeri.info/aktuale/284661/politikanet-i-cojne-femijet-ne-shkolla-te-shtrenjta/

[18] Vetëvendosje i ka mobilizuar vazhdimisht protestat e mëdha anti-qeveritare dhe ka hedhur gaz lotsjellës për të penguar parlamentin. Shih Reuters, Protestuesit konforntohen me policinë përderisa Kosova aprovon Marrëveshjen me Serbinë[Protesters Fight police as Kosovo approves Serbia Deal, 27 qershor 2013, në https://www.reuters.com/article/us-kosovo-protests/protesters-fight-police-as-kosovo-approves-serbia-deal-idUSBRE95Q0P420130627; Balkan Insight, Opozita e Kosovës organizon protesta antiqeveritare [Kosovo opposition Stage Anti-Government Protest], 18 prill 2015, në https://balkaninsight.com/2015/04/18/kosovo-opposition-stage-anti-government-protest/; Radio Evropa e Lirë, Katër të dënuar në Kosovë për sulmin ndaj Kuvend të vitit 2016 [Four Sentenced in Kosovo for 2016 Parliament Attack], 17 nëntor 2017, në https://www.rferl.org/a/four-sentenced-kosovo-parliament-attack/28860390.html; CNN, Partia opozitare hedhë gaz lotsjellë në Kuvendin e Kosovës [Opposition Party Sets Off Tear Gas in Kosovo Parliament], 21 mars 2018, në https://edition.cnn.com/2018/03/21/europe/kosovo-parliament-tear-gas-intl/index.html, dhe Pristina Insight, Vetëvendosje bën thirrje për protesta kundër qeverisë [Vetevendosje Calls for a New wave of Protests Against the Government], 4 prill 2019, në https://prishtinainsight.com/vetevendosje-calls-for-new-wave-of-protests-against-the-government/.

MADHËSIA DHE STRUKTURA E KABINETIT

Madhësia e duhur e Qeverisë dhe përmisimi i kordinimit të politikave dhe performancës

Pa një ligj specifik për rregullimin e përbërjes, strukturës dhe funksionimit të qeverisë, proceset e formimit të koalicioneve historikisht kanë shpier drejt qeverive të mëdha, për t'i akomoduar kështu palët e ndryshme, gjë që rezultonte me departamente të shumta të vogla, por me pak fuqi.[19] Qeveria e fundit shënoi rekord, me 21 ministri dhe me mbi 80 zëvendësministra, funksioni i të cilëve më tepër ishte dekorativ se faktik.[20] Një raport hulumtues që ndërlidhet me 100 ditët e para të qeverisë, gjeti se "një ushtri zëvendësministrash" ishte angazhuar në takime ndërmjet vete dhe me zyrtarë të tjerë, ndonëse kishin fare pak lidhje me prioritetet apo nismat e qeverisë; vetëm për rrogat e tyre shpenzoheshin mbi një milion euro në muaj, pa i llogaritur edhe beneicionet tjera. [21]

Rrjedhimisht, nuk befason fakti se shumica e partive politike gjatë fushatës premtonin zvogëlimin e kabinetit, shkurtimin e numrit të ministrave dhe kufizimin e zëvendesministrave në vetëm dy për ministri. Madhësia e tepruar e qeverive të kaluara, që ishte rezultat i koalicioneve pas zgjedhjeve e jo i ndonjë vendimi politik, i minonte proceset e koordinimit dhe të hartimit të politikave. Në këtë kuptim, edhe Vetëvendosje edhe LDK zhvilluan fushata duke folur për formimin e një qeverie që do të përbëhej nga 12 ministri.[22]

Politika kosovare duhet ta braktis politikën e përdorimit të ministrive si "vend-parkime" për partnerët e koalicionit. Qeveria e re duhet ta ulë numrin e ministrive në një numër të arsyeshëm. Nuk ekziston një madhësi ideale e qeverisë në praktikë; një studim i udhëhequr nga Komisioni Evropian tregoi se shumica e shteteve evropiane kanë diku ndërmjet 12 dhe 18 ministri, ndërkohë që 14 është numri më i zakonshëm.[23] Në rastin e Kosovës, ekzistojnë një sërë fushash ku konsolidimi do të mund të zhvillohej lehtë; Zhvillimi Ekonomik mund të shkrihet me Tregtinë dhe Industrinë, ndërkohë që ministria e re mund t'i përthithë edhe Inovacionin e Sipërmarrësinë, dhe Zhvillimin Rural. Ministria e Diasporës mund të shndërrohet në departament të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Ministria e Administratës Publike, e cila mund të marrë përsipër Administratën e Pushtetit Lokal, duhet ta ketë një rol më të fuqishëm në fuqizimin e shërbimit publik, rregullave kryesore dhe shërbimeve për të gjithë sektorët e qeverisë, duke vepruar kështu në nivel administrativ. Ngjashëm, figura e zëvendësministrit duhet përdorur për koordinimin e fushave dhe politikave brenda një ministrie, e jo për shpërblimin e anëtarëve të partisë. Sa i përket ministrave, qeveria e re duhet ta prioritetizojë emërimin e personave kompetentë për këto pozita, gjegjësisht që kanë përvojë të rëndësishme për këtë sektor. Ngjashëm, përfaqësuesit e komuniteteve duhet të ofrojnë portfolio relevante me shtrirje të gjerë, e jo vetëm aso që eksluzivisht

[19] Tendenca për një hipertrofi qeveritare nuk ka nisur me Haradinajn, megjithëse ai këtë dukuri e shpiu në një nivel të ri. Isa Mustafa po ashtu i kishte 45 zëvendësministra dhe 19 ministri, madje një pjesë të ministrave i kishte edhe pa portfolio. Shih Kallxo, Mustafa vs Hardinaj: Qeveria me shumë zëvendësministra, 5 dhjetor 2017, në https://kallxo.com/krypometer/mustafa-vs-haradinaj-qeveria-shume-zevendesministra/

[20] Gazeta Express, *Shumë zëvendësministra e pak punë*, 13 tetor 2018, në https://www.gazetaexpress.com/lajme-shume-zevendesministra-e-pak-pune-585006/

[21] Prishtina Insight, *Nga lopët te njerëzit: Si e kalon kohën një ushtri* zëvendësministra*sh n*ë Kosovë *[Of cows and men: How an army of Kosovo deputy ministers spend their time]*, 27 korrik 2018, në https://prishtinainsight.com/of-cows-and-men-how-an-army-of-kosovo-deputy-ministers-spend-their-time-mag/.

[22] Prishtina Insight, *Partitë politike zotohen se do ta zvogëlojnë numrin e ministrive n*ë qeveri *[Political parties pledge to cut government ministries]*, 26 shtator 2019, në https://prishtinainsight.com/political-parties-pledge-to-cut-government-ministries/

[23] Komisioni Evropian, *Një përmbledhje krahasuese e karakteristikave të administratës publike dhe e performancës në EU28 [A comparative overview of public administration characteristics and performance in EU28]*, Bruksel, 2018, në http://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=19208&langId=en

mbulojnë çështje të komunitetit, në mënyrë që të lehtësohet integrimi dhe përfshirja e tyre politike.

REKOMANDIME:

- Emëroni një qeveri me **15-16 ministri**, përqëndrohuni në rritjen e performancës së ministrive dhe deparatmenteve, dhe shmangni ristrukturimin e gjatë të saj;
- Organizoni qeverinë ashtu që struktura e kabinetit të korrespondojë me **prioritetet dhe nevojat sektoriale të shtetit**, me departamente që mbulojnë të gjitha fushat e rëndësishme (Arsimi, Shëndetësia, Zhvillimi Ekonomik, Bujqësia, Mjedisi, Drejtësia, Integrimi Evropian, Punët e Jashtme);
- Emëroni **kandidatë të aftë** dhe kredibil për poste qeveritare;
- Shtyjeni përpara **Ligjin për Qeverinë**, për të rregulluar strukturën, madhësinë dhe përbërjen e saj, me një mbështetje sa më të gjerë të mundshme politike;
- Rritni **përfaqësimin e grave** në pozita të larta - në nivelin ministror jo më pak se përfaqësimi i grave në Kuvend, dhe **50 përqind** në nivel të kabineteve.
- Ngarkoni **zëvendësministrat** me detyra për **koordininimin** e politikave brenda ministrive të tyre.

ADMINISTRATA PUBLIKE

Implemnetimi i reformave dhe profesionalizimi i shërbimit civil

Qeveria në largim ka miratuar tri ligje të rëndësishme që e rregullojnë funksionin e shërbimit publik të vendit; Ligjin për Zyrtarët Publik, Ligjin për Pagat dhe Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.[24] Këto ligje synojnë rregullimin e statusit dhe pagave të administratës me 82,000 persona në listat e pagave. Mirëpo, legjislacioni dytësor nuk ishte përfunduar para zgjedhjeve të parakohshme, duke shkaktuar kështu vonesa të shumta.[25] Dhe, që çështjet të komplikohen edhe më tepër, në fillim të nëntorit Gjykata Kushtetuese vendosi masën e përkohshme të të Ligjit për Zyrtarët Publikë, deri në shkurt 2020. [26] Një muaj më vonë, në dhjetor 2019, edhe Ligji për Pagat pati të njëjtin fat, ngase Gjykata Kushtetuese urdhëroi suspendimin e tij deri në mars 2020.[27] Duke i pasur të gjitha këto parasysh, i gjithë procesi duket se mbetet i ngrirë gjatë muajve në vazhdim.

[24] Ligji për Zyrtarët Publik (shkurt 2019), Ligji për Pagat në Sektorin Publik (shkurt 2019) dhe Ligji për Organizmin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (shkurt 2019). Shih po ashtu Bashkimi Evropian në Kosovë, *Përfundimet e përbashkëta,* të dakorduara *mes BE-së dhe Kosovës, lidhur me Grupin e Posaçëm për Reformën e Administratës Publike [The joint agreed EU Kosovo conclusions of the Public Administration Reform Special Group*, 26 prill 2018, në https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo_en/44545/Kosovo's%20progress%20on%20Public%20Administration%20Reform

[25] Përkujdesësi, Ministria e Administratës Publike i lancoi konsultimet në shtator, për të përpiluar draftet e 3 rregulloreve të parapara me Ligjin për Zyrtarët Publik; Rregullorja mbi Deklaratën e Statusit të Zyrtarëve Publik, Rregullorja për Spespendimin, Shkarimin nga Shërbimi Civil dhe Rregullorja mbi Disciplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik. Për më shumë informata, shih https://map.rks-gov.net/page.aspx?id=1,5,885

[26] Ombudspersoni ka paraqitur një ankesë kushtetuese lidhur me pakon e ligjeve, duke konsideruar se ajo cenon pavarësinë dhe autonominë kushtetuese. Gjykata Kushtetuese është pajtuar në parim me nevojën e shpalljes së masave të brendshme, me qëllim të pandalimit të dëmit të pariparueshëm. Shih Vendimin mbi Masat e Brendshme në Rastin nr.K0203/19 Shqyrtimi kushtetues i neneve specifike të Ligjit nr. 06/L-114 mbi Zyrtarët Publikë, nr. i Ref.: VPM 1472/19, 25 nëntor 2019, në http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/ko_203_19_vmp_ang.pdf

[27] Koha.Net, *Kushtetuesja pezullon ligjin për paga deri me 30 mars 2020*, 12 dhjetor 2019, në https://www.koha.net/arberi/198698/kushtetuesja-pezullon-ligjin-per-paga-deri-me-30-mars-2020/

Këto vendime suspendojnë edhe mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian për Reformën e Administratës Publike..[28] Qeveria e re duhet që menjëherë të ndërrmarë veprime dhe riprocedojë ligjet e reja, nëse gjykata kushtetuese vendos të i suspendoj ato pjesërisht apo tërësisht, dhe të i vendos në fuqi deri më qershor të vitit 2020.

Veç kësaj, Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) dhe Strategjia Kombëtare për Modernizimin e Administratës kërkojnë më tepër veprime; kyçe është ristrukturimi i agjencive të pavarura dhe i bordeve.[29] Sipas planit, numri i agjencive do të ulet nga 79 në afro 40, ndëkohë që qeveria do të marr përsipër shumicën e atyre që janë themeluar nga Kuvendi. [30] Qeveritë e mëhershme nuk patën vullnet të ristrukturonin agjencitë e pavarura, të cilat shpeshherë punësonin militantë dhe anëtarë të partive të tyre politike. Një front tjetër për qeverinë e re do të jetë mungesa e vazhdueshme e fondeve dhe kapaciteteve për Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP-in), i cili është përgjegjës për zhvillimi profesional të shërbyesve civilë. Fuqizimi i këtij institucioni duhet të jetë prioritet, për të rritur kështu aftësitë dhe ekspertizën e punonjësve në shërbimin publik, ndërkohë që trajnimet për shërbyesit publik duhet të bëhen të detyrueshme.[31] Qeveria ka shënuar një progres të ngadaltë në fushën e planifikimit dhe koordinimit të politikave. Në vitin 2014, agjencitë qeveritare kishin mbi 220 prioritete të shpërndara në mbi 90 strategji, të cilat fragmentojnë planifikimin e politikave dhe e bënin procesin joefikas.[32] Qeveria e Isa Mustafës uli numrin e strategjive në 56 dhe prezantoi Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit (SKZH).[33] Megjithëkëtë, as kjo gjë nuk mjaftoi; vetëm Ministria e Punëve të Brendshme i ka 11 strategji, dhe dy të tjera që janë përfunduar së fundmi. Në vitin 2018, qeveria miratoi një udhëzim për riorganizimin e dokumenteve strategjike dhe të planeve të veprimit. [34]

Me mbështetjen e BE-së, Zyra e Planifikimit Strategjik ka lancuar Kornizën Kombëtare për Menaxhim Strategjik (KKMS), e cila synon të ndihmojë në planifikimin e politikave dhe në buxhetim, mbi bazën e prioriteteve sektoriale.[35] KKMS synon të modernizojë planifikimin e politikave dhe buxhetimin, duke e organizuar atë përgjatë sektorëve. Ky ndryshim i thellë kërkon mbështetje politike, ndryshim të mendësisë institucionale dhe një planifikim më efikas. Ajo duhet të avancohet krahas Ligjit të ri mbi Qeverinë dhe të ndihmojë në organizimin e qeverisjes mbi baza sektoriale.

---

[28] BE-ja ka o fruar një mbeshtetje direkte prej 25 milionë eurove në disa faza. Pagesa e parë prej 5,5 milionë eurove është realizuar së fundmi. *Programi i Veprimit për Kosovën * për vitin 2016- Pjesa II- Ndihma për sektorin e buxhetit, C(206) 8458 finale [Action Programme for Kosovo* for the year 2016 – Part II - Sector Budget Support, C(2016) 8458 final],* dhjetor 2016, në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/ipa2016_ks_action_programme_part_ii_annex.docx_.pdf

[29] Për më shumë informata mbi ERA I, shih Grupit për Ballkan, *Agjenda për Reformat Evropiane për Kosovën: Sfidat e një Plani të Mirë,* nëntor 2016; Grupit për Ballkan, *Agjenda për Reformat Evropiane: Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit,* tetor 2017, dhe Grupit për Ballkan, *Edhe një rrezik i madh për Kosovën: Qeveria Sfidon Agjendën,* shtator 2017

[30] Veprimi 1.4 i Agjendës për Reformat Evropiane kërkon "Realizimin e një shqyrtimi të pavarur të mekanizmave të llogaridhënies nga të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullatore". Këto masa janë të konkretizuara në Planin e Veprimit për Racionalizimin e Agjencive, që është i publikuar nga ana e Ministrisë së Administratës Publike, në https://map.rks-gov.net/desk/inc/media/BB5C24F7-AF28-440E-9505-A29FF9CB5105.pdf

[31] "Zhvillimi profesional i shërbyesve civilë vazhdon të jetë problem, përderisa [IKAP] nuk ka buxhet dhe kapacitete për të ofruar trajnimet e kërkuara", Komisioni Evropian, *Kosovo* 2019 Report*, 2019, f. 12. Shih po ashtu SIGMA, *Raporti i Monitorimit: Parimet e Administratës Publike - Kosovë, [Monitoring Report: The Principles of Public Administration – Kosovo]*, OECD, nëntor 2017

[32] Intervistë e Grupit për Ballkan, zyrtar qeveritar, Prishtinë, nëntor 2019

[33] Strategjia Kombëtare e Zhvillimit është adotuar formalisht më 22 janar 2016, dhe ajo synon të promovoj zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë, në kuadër të kornizës së MSA-së me BE. Ajo i përcakton prioritetet e qeverisë në ato fusha për periudhën 2016-2021, duke u përpjekur të harmonizojë prioritetet e ndryshme të ministrive dhe planet e tyre të veprmit, duke marrë parasysh ciklet e planifikimit të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndrimor, në mënyrë që ta riorganizoj ciklin politik sa më shumë që të jetë e mundur.

[34] Udhëzimi Administrativ (GRK) Nr. 07/2018 mbi Planifikimin dhe Draftimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, 16 prill 2018, në http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/04/UDH%C3%8BZIMI-ADMINISTRATIV-QRK-NR.-07-2018-P%C3%8BR-PLANIFIKIMIN-DHE-HARTIMIN-E-DOKUMENTEVE-STRATEGJIKE-DHE-PLANEVE-T%C3%8B-VEPRIMIT-28-03-2018.pdf

[35] Buxheti i shtetit bazohet në departamente dhe agjenci, dhe ndahet nga 57 organizata buxhetore.

Po aq me rëndësi, qeveritë e kaluara nuk arritën të parandalojnë nepotizmin dhe emërimin e zyrtarëve në baza partiake dhe të afërt me politikën. Kjo praktikë ka shkelur edhe marrëveshjen me Mbretërinë e Bashkuar për monitorimin dhe mbështetjen e punësimit të zyrtarëve publikë mbi bazë të meritave, e cila shpiu në ulje të rolit të donatorëve dhe rriti kritikat nga ana e komunitetit ndërkombëtar dhe shoqërisë civile.[36] Qeveria e re duhet ta rikthejë projektin, ta zgjerojë fushëveprimin e tij duke mbuluar një gamë sa më të gjerë institucionesh, dhe të përfshijë shoqërinë civile dhe ekspertë tjerë ndërkombëtarë për të siguruar punësime dhe emërime të bazuara në merita. Njëkohësisht, Ligji për Barazinë Gjinore duhet të shndërrohet në kriter për emërimin e zyrtarëve publik, me qëllim të rritjes së përfaqësimit të grave në të gjitha nivelet e qeverisë.[37] Kjo duhet të fillohet në nivelin politik (ministrat) dhe të mbulojë të dy administratat (sekretariatët e ministrive, drejtoritë dhe departamentet), si dhe pozitat e mirëbesimit (kabinetet dhe këshilltarët).

REKOMANDIME:

- Rishikoni me prioritet ligjet për **Reformën e Administratës Publike**, zgjeroni **konsultimet** me partitë politike, ekspertët, shoqërinë civile dhe institucionet e pavarura, veçanërisht ombudspersonin, në përputhje me vendimet ardhshme të Gjykatës Kushtetuese dhe sigurohuni që ligjet e reja të hyjnë në fuqi në qershor 2020.
- Zbatoni plotësisht dhe pa vonesa **ristrukturimin e agjencive të pavarura**;
- Emëroni **një zëvendëskryeministër për Koordinim të Politikave** dhe, së bashku me Zyrën për Planifikimin Strategjik, fuqizoni mekanizmat për koordinim të politikave;
- Reduktoni **Strategjitë** dhe riroganizoni **planifikimin e politikave** dhe prioriteteve në vijë me prioritetet e MSA-së dhe ERA-s, mbështetni Kornizës Kombëtare për Menaxhim Strategjik dhe **buxhetimin sektorial**;
- Ofroni mbështetje me buxhet të duhur dhe me personel për **Institutin e Kosovës për Administratë Publike**, fuqizoni legjislacionin dhe bëjini trajnimet të detyrueshme;
- Implementoni **Ligjin për Barazinë Gjinore** dhe rritni përfaqësimin e grave në qeveri dhe kabinete, fuqizoni masat afirmative dhe sanksionet kundër shkeljeve;
- Zgjeroni rolin e projektit të financuar nga Mbretëria e Bashkuar, apo të nismave të ngjashme, për **mbështetjen e procesit të rekrutimit të drejtë dhe të bazuar në merita**, si dhe të emërimeve të reja; rritni gamën e projekteve për të mbuluar sa më shumë institucioneve dhe ftoni më shumë ekspertë ndërkombëtarë dhe të shoqërisë civile për monitorimin e proceseve të rekrutimit dhe emërimeve.

[36] Prioriteti 1.6, Veprimi dhe Indikatori 6 i Agjendës për Reforma Evropiane i bën thirrje qeverisë që të veprojë në bazë të rekomandimeve të Agjencisë Kundër Korrupsionit, për të "siguruar implementimin e MtM, të nënshkruar ndërmjet kuvendit dhe qeverisë, nga njëra anë, dhe Ambasadës së Britanisë së Madhe në Prishtinë, nga ana tjetër, për emërimin e anëtarëve të bordeve të institucioneve dhe agjencive të pavarura, për të siguruar kështu një process përzgjedhës jopolitik, transparent dhe të bazuar në merita, dhe në përputhje me ligjin, për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullatore, dhe për ndërmarrjet publike". Shkelja e marrëveshjes për punësim në bazë të meritave është dokumentuar nga BIRN, shih Balkan Insight, *Përkatësia politike mbetet kualifikim për punësim* në Kosovë *[Political Affiliation Still a Job Qualification in Kosovo]*, 5 tetor 2018, në https://balkaninsight.com/2018/10/05/political-affiliation-still-a-job-qualification-in-kosovo-10-03-2018/

[37] Grupit për Ballkan, *Gratë në politikë, Barazia gjinore në politikë dhe vendimarrje,* shkurt 2018, në https://balkansgroës sup.org/blog/post/articles/grate-ne-politike-pabarazia-gjinore-ne-politike-dhe-vendimmarrje dhe Grupit për Ballkan, *Përfundimet e tryezës* së rrumbullakët mbi përfshirjen e grave: Përfaqësimi i pabarabartë i grave në politikë dhe *në vendimmarrje [Conclusions drawn from Roundtable on Inclusion of Women: Unequal Representation of Women in Politics and Decision–Making]*, Prishtinë, 26 shkurt 2018, në https://www.balkansgroup.org/storage/app/media/Conclusions%20of%20the%20political%20dialogue%20round-table/01.04.2019_BPRG_Conclusions%20of%20the%20political%20dialogue%20round-table_%20Inclusion%20of%20Ëomen%20in%20Politics%20and%20Decision-Making-edited.pdf

ERA DHE MSA

Përvetësimi i ERA-s dhe institucionalizimi i reformave

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) hyri në fuqi në prill të vitit 2016. Ky dokument, marrëveshja e parë kontraktuale ndonjëherë ndërmjet Kosovës dhe BE-së, përbmban 144 nene, 7 shtojca, 5 protokole dhe një Deklaratë të Përbashkët. Me synimin për mbështetjen e demokracisë, Sundimin e Ligjit, stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik, ajo hapi rrugë për një dialog politik të brendshëm dhe ndërkombëtar.[38] Po ashtu, mbuloi edhe një gamë të gjerë çështjesh praktike që ndërlidhen me tregtinë, doganat, pronësinë intelektuale dhe industriale dhe mbrojtjen e investimeve. [39]

Menjëherë pas hyrjes në fuqi të saj, Qeveria e Isa Mustafës prezantoi një Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së - (PKZMSA), i cili i parashihte veprimet afatshkurtëra dhe afatmesme të shpërndara përgjatë 3 blloqeve; Kritereve Politike, Kritereve Ekonomike dhe Standardeve Evropiane (që reprodukojnë 35 Kapitujt e negociimit eventual për anëtarësim).[40] PKZMSA, i cili është një dokument i pastër kombëtar, shumë shpejt u zëvendësua me Agjendën më të detajuar për Reforma Evropiane (ERA), një nismë kjo e përbashkët e Qeverisë dhe Bashkimi Evropian, e cila u lancua në nëntor të vitit 2016. ERA është rezultat i dialogut të nivelit të lartë, që synon konkretizimin e veprimeve të nevojshme për zbatimin e MSA-së, me një kalendar të implemnetimit të saj deri në fund të vitit 2017.[41] ERA kështu "gëlltiti" PKIMSA-në, e cila u zbatua vetëm derisa s'u mbulua nga ERA.[42]

Por, ERA nuk arriti të implementohej tërësisht; plani ambicioz hasi në mungese vullneti e stkruture për implemntim nga ana e qeverisë. Tri shtyllat e saj ishin konceptuar njësoj të rëndësishme, megjithëse qeveria në largim, njësoj sikurse paraardhësja e saj, u përqëndrua vetëm në veprimet që ndërlidheshin me 'Qeverisjen e Mirë dhe Sundimin e Ligjit', duke i konsideruar 'Klimën e Konkurrencës dhe Investimet' dhe 'Punësimin dhe Arsimin' si sekondare. Pas ardhjes në krye të qeverisë, Ramush Haradinaj kishte premtuar se do ta përfundonte atë para se ai perfundoi mandatit të tij. [43]

---

[38] Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian për Energji Bërthamore, nga njëra anë, dhe Kosovës*, nga ana tjetër, Bruksel, 2 tetor 2015, Neni 1, në https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/stabilisation_and_association_agreement_eng_0.pdf

[39] Procesi i Stabilizim Asociimit, që synon të lehtësojë rindërtimin dhe integrimin përfundimtar të Ballkanit Perëndimor në BE, është lancuar në vitin 1999. Procesi përbëhet nga një sërë marëveshjesh bilaterale të cilat lehtësojnë qasjen në tregun e brendshëm për shtetet e rajonit, që përcillen me një ndihmë gjeneroze e ndihmave që tashmë njihet si Instrumenti i Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA). Qëllimi është përgatitja e ekonomive të shteteve të përfshira dhe e aparateve shtetërore për presionet që vijnë bashkë me anëtarsimin në BE. Gjatë dekadës së ardhshme, BE do të nënshkruaj Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me secilin shtet të rajonit. Kosova ishte shteti i fundit që e nënshkroi MSA-në, në vitin 2015.

[40] Qeveria e Kosovës, *Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit* [*National Program for the Implementation of the Stabilization and Association Agreement]*, Prishtë, mars 2016, në http://meiks.net/repository/docs/3_pkzmsa_miratuar_nga_kuvendi_final_eng_.pdf

[41] Qeveria e Kosovës, *Dialogu i nivelit të lartë Kosovë –BE rreth priroiteteve kryesore - Agjenda për Reformat Evropiane [Kosovo- EU High Level Dialogue on Key Priorities – European Reform Agenda]*, Prishtinë, nëntor 2016, në https://www.meiks.net/repository/docs/era_final.pdf. Shih po ashtu Grupit për Ballkan, *Agjenda e Reformave për Evropë dhe Sundimi i Ligjit [European Reform Agenda: Good Governance and Rule of Law*, tetor 2017

[42] PKZMSA i parashikoi masat për implementim që kërkohen nga institucionet publike. Raporti i fundit i Ministrisë së Integrimeve Evropiane tregon se niveli i implementimit në fund të vitit 2018 ishte 68.23 përqind, me 363 raste të kompletuara dhe 169 të mbetura pezull. Dokmenti i plotë mund të shqyrtohet në uebfaqen e minstrisë, në http://mei-ks.net/repository/docs/20190530071808_anglisht2018.pdf

[43] Grupit për Ballkan, *Agjenda për Reformat Evropiane: Raporti i Progresit për Qeverisje* të *Mirë dhe Sundim* të *Ligjit [European Reform Agenda: Progress Report on Good Governance and Rule of Law]*, tetor 2017, në https://balkansgroup.org/blog/post/publications/european-reform-agenda-progress-report-good-governance-and-rule-law

Mirëpo, ai dështoi ta përmbushte këtë premtim, meqë deri në fund të vitit 2017 ERA ishte përmbushur vetëm pjesërisht; madje edhe një vit më vonë ishin përfunduar më pak se dy të tretat e veprimeve të parashikuara të saj, me një 20 përqindësh shtesë të ekzekutuar pjesërisht tek në fund të vitit 2018.[44]

ERA është e dizajnuar si një tërësi koherente, qëllimet e së cilës mund të arrihen vetëm pasi të jetë zbatuar plotësisht. Veprimet individuale nuk kanë efekt të njëjtë po që se nuk mbështeten me nisma të ngjashme. Për shembull, në mars të vitit 2018 Kuvendi miratoi ligjin e ri për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ndërsa në janar 2019 u miratua Kodi i ri Penal, mirëpo Kodi i ri i Procedurës Penale, i cili duhej të harmonizohej me këto veprime tjera legjislative, nuk mundi të miratohej para shpërbërjes së kuvendit.[45] Pjesë tjera të rëndësishme të legjislacionit që mungojnë janë Reforma e vonuar Zgjedhore dhe Ligji për Financimin e Partive Politike.[46] Kjo e fundit, posaqërisht, doli të jetë përçarëse, sepse drafti i prezantuar në qershor 2019 nxiti protesta, për arsye se ai do ta legjitimonte mungesën transparencës dhe llogaridhënies.[47] Çfarëdo drafti i ri ka nevojë për konsulta të gjëra dhe, si pikënisje, duhet t'i marrë parasysh rekomandimet e Komisionit të Venecias. Në fushën e 'Konkurrencës dhe Investimeve' qeveria ka dështuar të propozojë një Ligj për Inspektimet, por edhe që ta riorganizojë sektorin e energjisë duke e përafruar atë me legjislacionin evropian, siç edhe pritet. Ngjashëm, reforma në arsim ka ngecur, ngase mungojnë ligjet e rëndësishishme në këtë fushë, në ndërkohë që ministria e arsimit mbetet e paaftë ose e papërgatitur që të nisë disa nga nismat e parashikuara.

Fatkeqësisht, fryma e ERA-s ka humbur diku në letra e dokumente.[48] Ajo ishte dizajnuar si një udhërrëfyes i vetëm për një gamë të gjerë veprimesh që do t'i shërbenin riorganizimit të administratës publike dhe nxitjes së një ekonomie funksionale të tregut, e cila do të varej domosdoshmërisht nga reformimi i thellë i arsimit. Fatkeqësisht, kjo pothuajse menjëherë u shndërrua në një "kërkesë" të BE-së për qeveritë e njëpasnjëshme. Qeveria e re duhet ta kuptojë se veprimet e ERA-s nuk janë aty sepse kërkohen, por për shkak se janë të dobishme. Si rrjedhojë, qeveria duhet ta prioritetizojë zbatimin e të gjitha veprimeve të pezulluara të ERA-s.

Në mënyrë të ngjashme, sapo ta marrë detyrën, qeveria duhet të fillojë me implementimin e ERA II. Marrëveshja, tashmë e përfunduar, nuk është lancuar ende zyrtarisht. Mirëpo, korniza e saj përmban një numër veprimesh që do t'i vazhdonin reformat që janë në zhvillim e sipër. Pavarësisht mosnënshkrimit, ato mund të lancohen në çdo kohë.

44 ERA i parashikon 149 veprime që duheshin implementuar deri në fund të vitit 2017, por deri në atë kohë janë implementuar vetëm 58 (38.9 përqind), shumica e të cilave kanë të bëjnë me reformat në Qeverisjen e Mirë dhe Sundimin e Ligjit. Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Instituti GAP dhe Instituti Prishtina për Studime Politike, *Një ERA e stagnimit [An ERA of Stagnation]*, maj 2018, f. 3. Për vitin 2018, pas disa riformulimeve, ERA kishte 108 veprime në pritje, 68 pej të cilave kishin përfunduar dhe 19 kishin mbetur të painicuara deri në fund të vitit. Shikuar për nga shtyllat, vetëm 10 përqind e veprimeve të parapara brenda shtyllës së parë kishin mbetur të painicuara, pëderisa ky numër dyfishohej në dy shtyllat e tjera, gjë që gjithashtu rezultonte me një normë shumë më të ulët të kompletimit. Të dhëna më të detajuar mund të shihen tek Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Instituti GAP dhe Instituti Prishtina për Studime Politike, *Agjenda për Reformat Evropiane: Raport Monitorimi për vitin 2018*, shkurt 2019, f. 4

45 Draft Ligji për Procedurën e Kodit Penal e ka kaluar leximin e parë në maj të vitit 2019. Agjenda e procesit legjislativ është e qasshme në http://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=176

46 Reforma elektorale përmban një nga 9 prioritetet e Qeverisjes së Mirë dhe Sundimit të Ligjit. Ajo përfshinë edhe dy masa të dallueshme; dispozitivin e pakos së plotë të legjislativit që do të reformonte proceset zgjedhore në përputhje me komentetet e misioneve të njëpasnjeshme të BE për monitorimin e zgjedhjeve dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias, dhe draftimin e një ligj të ri mbi Financimin e Partive Politike, i cili paraprakisht ishte konsultuar edhe me Komisionin e Venecias.

47 Prishtina Insight, *Protestuesit e kundërshtojnë ligjin e ri për financimin e partive politike [Protestors reject new law on political party funding*, 17 qershor 2019, në https://prishtinainsight.com/protesters-reject-new-law-on-political-party-funding/

48 Një shembull i jashtëzakonshëm për këtë është auditimi i jashtëm i partive politike. Ligji i aplikueshëm parasheh që librat e tyre kryesorë të auditohen njëherë në vit, dhe që rezultatet duhen të bëhen publike. Mirëpo, për shkak të mungesës së vullnetit të mirë kjo gjë nuk ka ndodhur që nga viti 2013. ERA I e ka përfshirë në veprimin 7.2 "Publikimin e raporteve financiare të partive politike, ashtu siç parashikohet me ligj". Autoritetet i kanë kompletuar dhe publikuar përfundimisht auditimet e tyre deri në vitin 2017. Megjithëse, atyre iu duhet që deri në dhjetor 2019 ta lancojnë edhe auditimin e vitit 2018, veprim ky që tashmë është listuar si i përfunduar.

E organizuar përgjatë 3 shtyllave të njëjta si të ERA I, ERA II bazohet në veprimet tashmë të përfunduara, të cilat mundësojnë vazhdimin e procesit të reformave. Ajo i rikthen veprimet e ERA I të cilat nuk janë përfunduar, si përfundimi i kornizës legjislative që ndërlidhet me luftën kundër korrupsionit dhe me reformën zgjedhore, apo me avancimin e Reformës së Administratës Publike. Ajo gjithashtu prezanton edhe veprimet e reja, siç është reformimi i Ministrisë së Arsimit përgjatë linjave të propozuara në Rishikimin Funksional të Rendit dhe Ligjit, i cili është i përfshirë në ERA I. Veç kësaj, ERA II fokusohet njdeshëm në qështjet e mjedisit për sa i përket objektivave mbi energjitë e rinovueshme, dhe të çështjeve si cilësia e ajrit dhe efiçienca e energjisë.

Rëndësia e ERA(ve) dhe e reformave tjera që ndërlidhen me mardhëniet me BE-në interpretohen edhe si lidhje me procesin e liberalizimit të vizave. Pa asnjë dyshim, të gjitha kriteret e përfshira në dialogun për viza janë plotësuar, mirëpo vazhdimi i dukshëm i reformave siguron argumente shtesë për ata akterë brenda institucioneve evropiane që po ushtrojnë presion për hyrjen sa më të shpejtë që të jetë e mundur të regiimit pa viza për Kosovën në legjislacionin e BE-së. Prandaj, qeveria duhet të shtojë ritmin e reformave krahas lobimit tek vendet anëtare të BE-së për sigurimin e udhëtimeve pa viza.

REKOMANDIME:

- Promovoni dhe përmbyllni **implementimin e ERA I** gjatë vitit 2020;
- Lanconi **ERA II**, dhe kërkoni nga BE-ja të ju mbështesë në implmentimin e saj;
- Integroni prioritetet e ERA II në fushëveprimet e **PKZMSA-s**;
- Ri-inicioni **Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për Financimin e Partive Politike dhe Ligjin për Inspeksione**;
- Inicioni dhe bashkëpunoni me Kuvendin dhe Kryesinë për bërjen e **Reformës Zgjedhore**, tanshmë të vonuar skajshmërisht;

DIALOGU ME SERBINË

Revitalizimi i dialogut dhe respektimi i marrëveshjeve

Dialogu me Serbinë ka ngecur që nga gushti i vitit 2015. E ardhmja e këtij procesi është e paqartë, për shkak se qeveritë e Kosovës dhe Serbisë dështuan në zbatimin e plotë të marrëveshjeve të arritura.[49] Vendimi i BE për të shtyrë – shumëkush beson për të pezulluar – perspektivën e zgjerimit për Ballkanin Perëndimor e ka dobësuar edhe më tepër mundësinë për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare mes Prishtinës dhe Beogradit.[50] Motivimi kryesor i të dy vendeve për përfshirje në dialog ishte premtimi për anëtarësim në BE, një mundësi kjo që tani është zbehur, dhe pa të cilën ka fare pak nxitje për vazhdim të bisedimeve. [51]

Qeveritë e njëpasnjëshme, të Isa Mustafës (2014-2017) dhe Ramush Haradinaj (2017-2019), hezituan të përfshiheshin në dialog apo edhe t'i implementonin marrëveshjet e ndjeshme që u arritën në Bruksel.[52] Megjithatë, ka pasur pak progres në ndërkohë në implmentimin e tyre; Traktati i Komunitetit të Energjisë, me qendër në Vjenë, u nënshkrua me 1 shkurt 2019, duke e certifikuar kështu operatorin e sistemit të transmisionit të Kosovës.[53] Në vitin 2016, Kosova fitoi kodin e saj shtetëror, i cili njihet nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit.[54] Një progres është vërejtur edhe tek certifikimi i diplomave të Universitetit të Mitrovicës së Veriut që financohet nga Beogradi, tek vlefshmëria e patentshoferëve, dokumentet e regjistrit civil dhe integrimi i gjykatave në veri të Kosovës.[55] Si marrëveshje tjera të suksesshme deri më tani janë dëshmuar ajo e Menaxhimit të Integruar të Kufijve, e Bashkëpunimit dhe Pjesëmarrjes në organizata Rajonale, Lirinë e Lëvizjes, Vulave Doganore, Zyrave Ndërlidhëse, Fondit nga të hyrat Doganore, Policisë dhe Integrimit e "Mbrojtjes Civile", Sigurimit e Automjeteve, si dhe pakos së marrëveshjeve që kanë të bëjnë me integrimin e pjesës veriore dhe komuniteti serb.[56]

---

[49] Grupit për Ballkan, *Asociacioni i komunave serbe: Të kuptuarit e pikëpamjeve kontradiktore të shqiptarëve dhe serbëve,* janar 2017, në https://balkansgroup.org/blog/post/publications/association-serb-municipalities-understanding-conflicting-views-albanians-and-serbs

[50] Në tetor të vitit 2019 BE vendosi që të mos i hapë bisedimet me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, Këshilli i Evropës, *Konkluzionet e Presidencës* rreth procesit të zgjerimit, *dhe stabilizim asociimit[Presidency Conclusions on Enlargement and Stabilisation and Association Process]*, Strasburg, 15 tetor 2019, në https://www.consilium.europa.eu/media/41067/st13155-en19.pdf. MSA, strategjia më e fundit e zgjerimit dhe Kapitulli 35 mbi bisedimet e Serbisë me BE-në për anëtarësim, varen nga ajo nëse dialogu do të vazhdojë. Vendimi i Këshillit e ka kërcënuar këtë mundësi, duke e dobësuar kështu ndikimin e BE-së. Në një intervistë për Financial Times, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vucic, deklaroi se ndjehet i shfajësuar falë politikës së tij për lidhje më të afërta me Rusinë dhe Kinën. Shih Financial Times, *Banka kombëtare ballkanike për lidhjet rajonale pas injorimit nga BE [Balkan Nations Bank on Regional Ties after EU Snub]*, 23 tetor, 2019, në https://www.ft.com/content/508dcea4-f4ce-11e9-b018-3ef8794b17c6.

[51] Nëse hiqet shpërblimi për anëtarësim në BE asnjëri shtet nuk do ta shtyjë përpara dialogun, e as implementimin në zhvillim e sipër të marrëveshjeve të arritura. Shih Balkan Insight, *Bllokimi i zgjerimit paraqet një akt evropian* të vetlëndimit [*Blocking Enlargement is a European Act of Self Harm]*, 4 nëntor 2019, në https://balkaninsight.com/2019/11/04/blocking-enlargement-is-an-act-of-european-self-harm/

[52] Pas takimit me zyrtarë evropian, në dhjetor 2018, Haradinaj deklaroi se "ne s'kemi më kohë për zgjidhje gjysmake", Radio Evropa e Lirë, *EU, Kosova mban një takim* të *tensionuar në Bruksel [Kosovo hold Tense Meeting in Brussels]*, 17 dhjetor 2018, në https://www.rferl.org/a/eu-kosovo-hold-tense-meeting-in-brussels/29661437.html

[53] Traktati për formimin e Komunitetit të Energjisë, Athinë, 25 tetor 2005, në https://www.energy-community.org/legal/treaty.html. Informacionit shtesë lidhur me impementimin e tij mund të qasen në https://www.energy-community.org/ implementation/Kosovo.html

[54] Kosova tani listohet në regjistrin në internet, ndërsa qytetarët e saj mund ta përdorin një kod të vetëm për thirrjet lokale ose ndërkombëtare, gjë që do të duhej të rezultonte me përfitime shtesë për buxhetin e vendit. Për më shumë infomata, shih Kosovo Serbia Policy Advocacy Group, *Tungjatjeta Kosovë?* [*Hello Kosovo?],* 29 gusht 2019, në https://balkansgroup.org/blog/post/articles/hello-kosovo dhe në Prishtina Insight, *Një kod për Kosovën [A code for Kosovo]*, 15 dhjetor 2016, në https://prishtinainsight.com/a-code-for-kosovo

[55] Marrëveshjet janë të qasshme në uebfaqet e të dy qeverive: Shih Marrëveshjen për Grada Universitare, në http://kim.gov.rs/eng/p10.php; Marrëveshjen për Regjistra e Gjendjes Civile, në http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/agreement_0210_civil_books.pdf; dhe Marrëveshjen për Drejtësinë, në http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Agreement_on_Justice_-_9_Feb_2015__1.pdf

[56] Të gjitha marrëveshjet e arritura në Bruksel, që nga viti 2013, janë të qasshme në http://kryeministri-ks.net/en/documents-en/ ?kategoria=technical-dialogue-agreements&viti#038;viti dhe në http://kim.gov.rs/eng/pregovaracki-proces.php

Marrëveshjet e tjera kanë ngecur. Ndërtimi i vendkalimeve të reja kufitare, njohja e targave të automjeteve, Asociacioni i Komunave me shumicë Serbe, kadastri, etj., kanë mbetur peng i mosmarrëveshjeve të mëdha politike, të cilat janë në rritje e sipër.

Që nga vera e vitit 2017, SHBA dhe BE-ja kanë shtyer për një dialog të nivelit të lartë, me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare mes dy vendeve.[57] SHBA organizoi vizita të shumta dhe presidenti Trump ua dërgoi dy letra liderëve të Kosovës dhe të Serbisë, për t'i nxitur ata të përgatiteshin për kompromisin përfundimtar, i cili do të përfshinte edhe njohjen reciproke. [58] Ngjashëm, edhe përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, gjatë seancës së elaborimit të tij para Parlamentit Evropian deklaroi se përfundimi i dialogut do të jetë një ndër prioritetet e tij.[59] Këto zhvillime kanë rezultuar me rritje të presionit ndërkombëtar për përmbylljen e shpejtë të një marrëveshjeje mes dy vendeve. [60]

Paralelisht, tensionet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit u rritën në një nivel tjetër.[61] Pas dështimit të anëtarësimit në Interpol, në tetor 2018, kryesisht shkaku i një fushate agresive diplomatike të Serbisë, Kosova vendosi tarifa të larta për mallrat serbe (dhe ato që vijnë nga Bosnja dhe Hercegovina).[62] Beogradi tani refuzon të përfshihet në bisedime, përderisa BE nuk ka bërë asnjë përpjekje për vazhdimin e dialogut në këto rrethana.[63] Kryeministri Haradinaj i ka rezistuar presioneve nga nivelet më të larta të bashkësisë ndërkombëtare për heqje të taksës. [64]

Brenda vendit, mosmarrëveshjet ndërmjet krerëve të institucioneve dhe akterëve politikë janë të dukshme. Këto zhvillime të dëmshme kanë përshfaqur brishtësinë politike të Kosovës, por edhe dobësinë e saj në planin ndërkombëtar, gjë që i ka tmerruar aleatët e shumtë te saj. Me largimin e kryeministrit Haradinaj pak gjë ka ndryshuar. Qeveria e re edhe mund të largojë tarifat ndaj mallrave serbe, që është një kërkesë e vazhdueshme e SHBA dhe e evropianëve, por një konsensus politik për dialogun mbetet ende larg.

---

[57] Shërbimi Evropian për Veprime të Jashtme, *Federica Mogherini takohet me presidentin e Serbisë Vučić dhe me z.Thaçi nga Kosova [Federica Mogherini meets with President Vučić of Serbia and Thaçi of Kosovo]*, Njoftim për media, Bruksel, 3 korrik, në https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/29156/federica-mogherini-meets-president-vu%C4%8Di%C4%87-serbia-and-tha%C3%A7i-kosovo_en

[58] Presidenti Trump u shkruan letër të dyja vendeve, Kosovës dhe Serbisë; Letra e presidentit Trump drejtuar presidentit Thaçi, 18 dhjetor 2018, në https://www.president-ksgov.net/en/news/president-thaci-received-a-letter-from-the-president-of-the-usa-donald-trump; dhe letra e presidentit Trump drejtuar presidentit Vucic, në https://ww.b92.net/eng/news/world.php?yyyy=2018&mm=12&dd=20&nav_id=105811

[59] Përfaq ësuesi i lartë për Punë të Jashtme i BE-së, Josep Borrell, deklaroi se vizita e tij e parë do të jetë në Prishtinë, dhe se "Një gjë është e qartë: Kosova dhe Serbia duhet ta arrijnë një marrëveshje. Kjo është me rëndësi. Dhe, unë do ta jap maksimumin për ta përmbushur këtë prioritet". Politico, *Si shef i politikës së Jashmte* të BE-së, Borell fillimisht do *ta vizitojë Kosovën [Borrell to Visit Kosovo First as EU Foreign Policy Chief]*, tetor 2019, në https://www.politico.eu/article/borrell-visit-kosovo-first-as-eu-foreign-policy-chief-commission-hearings/

[60] "Për arritjen e një marëveshjeje serioze, ekziston një pengesë ndërmjet nëntorit 2019 dhe marsit 2020," Atlantic Council, *Një Udhëzues për Dialogun e Kosovës me Serbinë [A Roadmap for the Kosovo Serbia Dialogue]*, 3 tetor 2019, në https://www.atlanticcouncil.org/blogs/neë-atlanticist/a-road-map-for-the-kosovo-serbia-dialogue/

[61] Në mesin e zhvillimeve hyjnë edhe dorëheqja e katër kryebashkiakëve të Veriut, në nëntor të vitit 2018, arrestimet në të dyshuarve për vrasjen e Oliver Ivanovic në Veri, në maj të vitit 2019, dhe arrestimet e disa policëve në veri, në maj 2019.

[62] Për më shumë informata, shih BBC, *'Kosova godet Serbinë me 100 përqind taksë tregtare, në kohën e kundërshtimeve rreth Interpolit' ['Kosovo Hits Serbia with 100 per cent Trade Tariffs amid Interpol Row']*, 21 nëntor 2018, në https://www.bbc.com/news/world-europe-46287975

[63] Për më shumë informata, shih Reuters, *Vučic i thotë Trumpit se Serbia do t'i rifillojë bisedimet me Kosovën vetëm pasi të hiqen taksat [Serbia to Resume Kosovo Talks only after it Scraps Tariffs, Vucic Tells Trump]*, 31 janar 2019, në https://www.reuters.com/article/us-serbia-usa-kosovo/serbia-to-resume-kosovo-talks-only-after-it-scraps-tariffs-vucic-tells-trump-idUSKCN1PP1X9

[64] Balkan Insight, *Samiti i Berlinit dështon që t'i rifillojë bisedimet e bllokuar mes Serbisë dhe Kosovës [Berlin Summit Fails to Restart Stalled Kosovo Serbia Talks]*, 30 prill 2019, në https://balkaninsight.com/2019/04/30/berlin-summit-fails-to-restart-stalled-kosovo-serbia-talks/, dhe Ballkani Lindor Evropian, *Shtyhet takimi në Paris [Meeting in Paris Postponed]*, 21 qershor 2019, në https://europeanëesternbalkans.com/2019/06/21/meeting-in-paris-postponed/

Gjykuar nga veprimet e kaluara, një koalicion hipotetik i udhëhequr nga Kurti nuk do të ishte i gatshëm të përfshihej në dialog në formatin ekzistues. Ai insiston se «fillimisht do t'i rishikoj marrëveshjet e arritura në Bruksel, e pastaj do të kërkojë që ta negocioj kornizën për dialog me Serbinë".[65] Me fjalë tjera, dialogu me Serbinë nuk është pjesë e listës së tij të prioriteteve. [66] Për më tepër, kjo qeveri në ardhje nuk duket se ka gatishmëri për t'i implementuar marrëveshjet e mbetura pezull.[67] Vlen të përmendet se LDK dhe Vetëvendosje kanë disa dallime; e para është më e ndjeshme ndaj kërkesave që vijnë nga bashkësia ndërkombëtare.

Megjithatë, nga qeveria e re pritet që menjëherë të përfshihet në dialog.[68] Me të drejtë; sepse është një obligim i saj kontraktual.[69] Për krijimin e një ekipi negociator, qeveria në ardhje duhet të koordinohet plotësisht me presidentin Thaçi dhe grupet më të mëdha parlamentare. Në rast të ri-inicimit të dialogut, presidenti dhe kryeministri duhet të përfshihen vetëm në takimet e nivelit të lartë, sikurse që do të ishte Samitit në Paris i cili mund të ndodh së shpejti, përderisa negociatat duhet të zhvillohen në një nivel më të ulët – në atë teknik. Ekipi negociator, sa më gjithëpërfshirës dhe me një rol më mirë të definuar, duhet që të shërbejë brenda vendit për të ndihmuar në ndërtimin e konsensusit dhe në përgatitjen sa më të mirë.[70]

Qeverisë së re i duhet të punojë në tri fronte, (1) në ndërtimin e konsensusit të brendshëm, (2) në përfshirjen në dialog, duke bashkëpunuar me ndërmjetësit e tij dhe (3) në koordinimin me aleatët ndërkombëtarë. Testi do të ndodhë shpejt. Qeveria duhet të jetë në gjendje që t'i kryejë këto negociata, dhe njëkohësisht të qeverisë dhe bëjë refomat e brenshme. Dialogu duhet t'i fuqizojë ato nisma, e jo ta shkëpus prej tyre.

---

[65] Në një intervistë televizive me Agron Bajrami, nga Koha Ditore, Kurti deklaroi se kur ai të marrë drejtimin e qeverisë së vendit, do t'i rishikojë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në dialogun me Serbinë, shih Koha Ditore, *Kurti: BE-ja nuk e zëvendëson bashkimin kombëtar*, 8 tetor 2019, në https://www.koha.net/zgjedhjet-2019/187992/kurti-te-enjten-pritet-te-takohemi-me-mustafen-e-osmanin/; Radio Evrpa e Lirë, *Kryeministri i mundshëm i Kosovës thotë se marrëdhëniet me Serbinë duhet të bazohen në " 'reciprocitet'[Kosovo's Likely PM Says Relations with Serbia Should be based on 'Reciprocity']*, 10 tetor 2019, në https://www.rferl.org/a/kosovo-s-likely-pm-kurti-relations-with-serbia-should-be-based-on-reciprocity-/30210319.html dhe Albin Kurti flet rreth dialogut mes Kosovës dhe Serbisë për the Guardian *"Nëse e duan fillimin e dialogut, ata duhet që menjëherë t'i ndalin shpifjet rreth të drejtës sonë për shtetësi" ['If they want to start dialogue, they should explicitly stop the slander about our right to statehood'*.

[66] Intervistë e Grupit për Ballkan, një anëtar i lartë i Vetëvendosjes, Prishtinë, 20 tetor 2019

[67] Që nga koha e nënshkrimit të saj, në vitin 2013,Albin Kurti e ka kundërshtuar vazhdimisht Marrëveshjen për Komunat Serbe, madje në një intervisë për Syri Vision, në tetor 2019, ka deklaruar se "Asociacioni ka vdekur". Shih lajmi.net, *Kurti thotë se asociacioni ka 'vdekur'*, 21 tetor 2019, në https://lajmi.net/kurti-thote-se-asociacioni-ka-vdekur/

[68] SHBA kanë emëruar dy përfaqësues special: Matthew Palmer për Ballkanin Perëndimor, dhe Richard Grenell, ambasador në Gjermani, si përfaëques special për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Disa ditë pas zgjedhjeve nacionale të tetorit, përfaqësuesit i kanë vizituar Prishtinën dhe Beogradin. Shih Ballkani Perëndimor Evropian, *Rrichard Grenell emëroher përfaqëesuesi special për dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit [Richard Grenell named US Special Envoy for Belgrade-Pristina dialogue]*, 4 tetor 2019, në https://europeanwesternbalkans.com/2019/10/04/richard-grenell-named-us-special-envoy-for-belgrade-pristina-dialogue/ Ngjashëm, edhe përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, synon të emëroj një përfaqësues të vetin. Intervistë e Grupit për Ballkan, zyrtari qeveritar gjerman, Berlin, 5 dhjetor 2019.

[69] Nenet 5 dhe 13 të MSA-së afirmojnë përkushtimin e Kosovës ndaj politikës së dialogut me Serbinë. Tutje, Komisioni ka lidhur arritjen e marrëveshjes finale më anëtarësimin përfundimtar të dy vendeve. Shih Komisioni Evropian, *Një perspektivë e besueshme e zgjerimit dhe një përfishje* më e theksuar e *BE-së në Ballkanin Perëndimor[A Credible Enlargement Perspective for and Enhanced EU Engagement with the Western Balkans]*, COM(2018) 65 finale, Strasburg, 6 shkurt 2018, në https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf

[70] Në mars 2019, opozita hapi në Gjykatën Kushtetuese rastin e Ligjit për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Republikën e Serbisë. Më 27 korrik 2019, rastin në fjalë, Gjykata e shpalli për jokushtetues, duke e shpërbërë kështu ekipin negoiciator. Për më shumë informata shih Balkan Insight, *Gjykata e Kosovës e shpall 'jookushtetues' ekipin negociator [Kosovo Court Declares Negotiating Team 'Unconstitutional']*, 27 qershor 2019, në https://balkaninsight.com/2019/06/27/kosovo-court-declares-serbian-negotiation-team-unconstitutional/

REKOMANDIME:

- **Pezulloni tarifat** ndaj mallrave serbe; kërkoni nga BE që të mbështes zbatimin e shpejtë të marrëveshjeve të paimplemntuara, me fokus në vendkalimet kufitare, njohjen e diplomave, targat e automjeteve dhe energjinë;
- **Angazhohuni në dialog,** bashkëpunoni me lehtësuesit dhe koordinohuni me aleatët ndërkombëtarë;
- Emëroni një **ekip** gjithëpërfshirës dhe të defniuar mirë negociator, në koordinim me presidentin dhe kuvendin, i cili përfshinë opozitën dhe ekspertët, si dhe respektoni Ligjin për Barazi Gjinore. Ekipi negociator duhet të jetë në vartësi të kryeministrit dhe presidentit, dhe t'i raportojë kuvendit;
- Vlerësoni **nivelin e implementimit të marrëveshjeve,** vazhdoni me implmentimin e marrëveshjevetë sukseshme dhe ndërmerrni veprime për zbatimin e marrëveshjeve të ngecura;
- **Koordinohuni me të gjithë akterët e brendshëm** (presidentin, kuvendin, ministritë, shoqërinë civile dhe komunitetet), për të siguruar një mbështetje të gjerë për procesin e dialogut

POLITIKA E JASHTME

Rishikimi i politikës së jashtme dhe riorganizmi i ministrisë

Deri më tani politika e jashtme ishte e thjeshtë; rreshtimi përkrah aleatëve perëndimorë, kundërshtimi i fushatës armiqësore të Serbisë kundër pavarësisë së vendit, dhe kërkimi i më shumë njohjeve ndërkombëtare.[71] Viteve të fundit kjo politikë është bërë e pamjaftueshme; Kosova dështoi të kuptonte ndryshimet në zhvillimet ndërkombëtare dhe të përkushtohej ndaj nevojave të vendit. Duke mos qenë anëtare e Kombeve të Bashkuara, politika e jashtme mbetet njëri prej prioriteteve më të rëndësishme ku vendi duhet të investojë shumë. Arritja e një marrvëshjeje me Serbinë do ta zhbllokonte automatikisht njohjen e plotë ndërkombëtare të Kosovës, kështu që kjo çështje duhet trajtuar me seriozitet. Paralelisht, qasja deri tek të gjithë akterët dhe institucionet që mund ta ndihmojnë ose dëmtojnë statusin ndërkombëtar të vendit dhe zhvillimin e tij ka rëndësi të madhe.

Me një buxhet prej 32 milionë eurove për vitin 2019, Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) mezi mirëmbanë rrjetin prej 28 ambasadave dhe disa konsullatave shtesë në shtetet ku jeton një komunitet i madh kosovar.[72] Kjo, krahas njohurive jashtëzakonisht formale dhe njohurive të pamjaftueshme të marrëdhënieve ndërkombëtare, ka shpier në krijimin e një komuniteti diplomatik që brengoset vetëm për statusin e vendit; ose, thënë më qartë, që merret vetëm me "mbledhjen e njohjeve". Mirëpo, sapo të vije ndonjë njohje e re, nuk dinë se çfarë të bëjnë me të. Si rezultat, Kosova ka dështuar që të krijojë raporte me shumicën e shteteve që e kanë njohur, gjë që vendin e ka lënë 'pa zë' në kryeqytetet përkatëse, e cila shpesh ka rezultuar me pengesa të jashtëzakonshme, përfshirë këtu një numër "të

[71] Koha Ditore, *Haradinaj në televizionin serb: S'kemi politikë të jashtme, ndjekim atë të Amerikës*, 16 prill 2018, në https://www.koha.net/arberi/87590/haradinaj-ne-televizionin-serb-skemi-politike-te-jashtme-ndjekim-ate-te-amerikes/

[72] Vendi ka themeluar ambasada në 13 shtete anëtare të BE-së (Austri, Belgjikë, Bullgari, Kroci, Republikën Çeke, Francë, Gjermani, Hungari, Itali, Holandë, Slloveni dhe Suedi, plus në Mbretërinë e Bashkuar). Në Evropë ekziston edhe ambasada në Zvicër. Dy ambasada në Afrikë (Egjipt dhe Senegal) dhe në Lindjen e M esme (Arabi Saudite dhe Emirate të Bashkuara Arabe), dy në Amerikën Veriore (SHBA dhe Kanada), një në Amerikën Qendrore (Panama), dhe një në Azinë Lindore (Japoni), e përmbyllin rrjetin. Lista e plotë e misioneve diplomatike jashtë vendit mund të konsultohet në uebfaqen e Ministrisë së Punëve të Jashtme, në http://www.mfa-ks.net/misionet/493/ambasadat-e-republiks-s-kosovs/493

çnjohjeve".[73] MPJ-ja vazhdon me luftimin e kësaj "fushate të çnjohjeve".[74] Disa zyrtarë pretendojnë se kjo ishte vetëm punë e tyre në vitet e fundit; "ministria merret eksluzivisht me luftimin e çnjohjeve", në disa raste pa sukses.[75]

Megjithëse shërbimi diplomatik ka disa shërbyes dhe diplomatë shumë cilësor, shërbimi mbetet shumë i politizuar, ngase pozitat kryesore shpeshherë iu caktohen familjarëve apo të favorizuarve politik, që s'kanë përvojë e as zotësi; shumica e të cilëve madje as nuk e flasin ndonjë gjuhë të huaj.[76] Kjo shpien drejt një demotivimi serioz, ngase "në qoftë se dikush nuk kërkon ndonjë lidhje politike, kurrë nuk do të promovohet".[77] Qeveritë e kaluara kanë dështuar në zbatimin e elementeve themelore të ligjit që ka të bëjë me standardet dhe kriteret e promovimit. Disa pretendojnë se punët e jashtme nuk janë më pak të politizuara se sa ministritë e tjera, duke iu referuar Arsimit apo Tregtisë.[78] Emërimet e parregullta masive ndodhin në kohë të zgjedhjeve ose në fund të mandatit të një ministri, «diplomatëve u janë paguar biletat e fluturimit për kthim në shtëpi, me qëllim të mbedhjes së votave për ministrin nëpër qytetet apo fshtatrat e tyre të lindjes".[79] Si rrjedhojë, edhe po qe se ekziston vullneti politik ose mbështetja për lobim efektiv jashtë vendit, MPJ-ja aktualisht nuk ka kapacitete për ndërmarrjen e detyrave madhore, ngase i mungon menaxhimi, përpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve, por edhe njohuritë për rajonet e përgjegjësisë. Ministria duhet që fillimisht të investojë shumë në infrastrukturën e saj dhe të fus në përdorim një sistem efektiv të shkëmbimit të informatave.

Ministria dhe kori diplomatik janë të organizuar dobët, por asnjëri nga ministrat nuk është përpjekur që ta përmirësojë këtë. Ata kanë dështuar në modernizimin e legjislacionit, në formimin e një politike domethënëse dhe në zhvillimin e koordinimit mes ambasadave apo brenda tyre, aq më pak me sektorët tjerë të qeverisë.[80] Skena tejet e paaftë dhe e polarizuar politike e Kosovës ka reflektuar në masë të madhe edhe në politikën e jashtme të vendit; performanca në skenën ndërkombëtare kryesisht është shikuar përmes 'lenteve' elektorale të komunave në vend, duke e kufizuar kështu atë si raport me publikun vendor, për një përfitim afatshkurtër të votave. Është shumë e qartë se në konferencat e njëpasnjëshme të ambasadorëve nuk u diskutua asnjë çështje me rëndësi, por ato u përdorën si një shfaqje për udhëheqësinë politike.[81] Sa i përket auditimit, del se performanca e ministrisë dhe e zyrave diplomatike është ndër më të dobëtat, ndonëse ambasadat nuk auditohen rregullisht, ndërsa puna e tyre

[73] Një përpjekje për anëtarësim në UNESCO dështoi në vitin 2015, pasi që u fituan 92 vota nga 95 sa kërkoheshin, ndërsa 50 ishin abstenime. Sipas MPJ, asokohe ishin 111 shtete që e kishin njohur Kosovën. Që nga atëherë, shteti dështoi tri herë që të anëtarësohej në INTERPOL (më 2015, 2016 dhe 2018), madje herën e fundit u mblodhën vetëm 76 vota, nga 88 që nevojiteshin.

[74] Përderisa ende mbetet diskutabile nëse një lëvizje e tillë është e mundur sipas ligjit ndërkombëtar, numri i shteteve që e kanë "çnjohur" Kosovën mbetet i paqartë. Zyrtarët serbë pohojnë se ky numër në nëntor 2019 ka shkuar në 17, përderisa MPJ e Kosovës, e nganjëherë edhe vetë shtetet e përfshira në këto lëvizje kontroverse, i hedhin poshtë këto pohime. Lista e shteteve "çnjohëse" mund të përfshijë Surinamin, Burundin, Papua Nju Guinean, Lesoton, Komoron, Dominikën, Grenadën, Ishujt Solomon, Madagaskarin, Palaun, Togon, Republikën e Afrikës Qendrore, Ganën dhe Naurun. Krahas këtyre 14 shteteve, Guinea-Bissau, Liberia dhe Sao Tome e Principe mund t'i kenë tërhequr vendimet pasi që emate e tyre u bënë publik.

[75] Intervistë e Grupit për Ballkan, zytrari i MPJ, Prishtinë, tetor 2019

[76] Një shtet evropian është tërhequr nga mbështetja e ministrisë, si rezultat i emërimeve politike dhe jokompetente të ambasadorëve në një vend mik dhe donator, Intervistë e Grupit për Ballkan, diplomati, Prishtinë, nëntor 2019

[77] Intervistë e Grupit për Ballkan, MPJ, zyrtar, Prishtinë, tetor 2019

[78] Intervistë e Grupit për Ballkan, MPJ, zyrtarë, qershor-nëntor 2019

[79] Intervista të Grupit për Ballkan me anëtarë të MPJ, gjatë viteve. Kjo informatë dhe dëshmi shfaqet, në veçanti, gjatë fushatave elektorale. Intervistat e fundit të Grupit për Ballkan me anëtarët e kësaj ministrie, Prishtinë, tetor-nëntor 2019

[80] Megjithëse tentimi i parë për modernizimin e kornizës ligjore ndodhi në vitin 2015, të gjitha kuvendet e radhës dështuan në miratimin e legjislacionit, madje secili draft i radhës u hodh poshtë nga komisonet, përpara se të largohej edhe përfundimisht pas shpërbërjes.

[81] Konferenca e fiundit e ambasadorëve, që u mbajt në vitin 2018, kryesisht shërbeu për promovimin e dallimeve ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe misioneve të saj nëpër botë. Shih Insajderi, *Haradinaj kritikon ambasadorët e Kosovës: interesohuni për vendin tuaj*, 6 shtator 2018, në https://insajderi.com/%E2%80%8Bharadinaj-kritikon-ambasadoret-e-kosoves-interesohuni-per-vendin-tuaj/

nuk monitorohet; parimisht, ministria nuk posedon asnjë sistem vlerësimi. [82]

Ambasadat dhe diplomatët nuk furnizohen me udhëzime, dhe prej tyre nuk kërkohen raporte të hollësishme apo të dhëna politike. Shkëmbimi i raporteve është i parregullt dhe shpeshherë sipërfaqësor. Diplomatët nuk thirren që të kontribuojnë në diskutimet e politikave në ministri; politikat dhe vendimet ad-hoc merren nga grupe të vogla (dhe shpeshherë me pak përvojë) në kabinet. Me pak përjashtime, ambasadat pothuajse nuk zhvillojnë asnjë aktivitet. Për shembull, promovimi kulturor nga ana e ambasadave nuk përputhet me skenën aktive kulturore në vend, përplot festivale, ekspozita dhe gara lokale. Ministria duhet të bashkëpunojë ngushtë me institucionet dhe organizatat kulturore, akademike e rinore, për promovimin e Kosovës në vendet e largëta. Po ashtu, ajo duhet të investojë në shkëmbimin e studentëve, në programe me vendet e tjera për gazetarë dhe rini, në veçanti me vendet që ende s'e kanë njohur Kosovën, por edhe në fusha të tjera.

Në mënyrë që politika e jashtme ta arrijë ndikimin e dëshiruar kërkohet një riorganizim urgjent i brendshëm i ministrisë. Për një rehabilitim të tillë, rëndësi të veçantë ka një ligj i ri që i definon procedurat operartive të ministrisë; qeveria e re duhet ta ri-inicojë me shpejtësi projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik.[83] Amandamentimi i ligjit duhet t'i rregullojë më mirë kriteret e parapara për shërbyes civilë, statusin e diplomatëve dhe emërimin e tyre. Ligji duhet të rregullojë një kornizë më të qartë të strukturës së ministrisë dhe të llogaridhënies së saj brenda dhe jashtë, në raport me autoritetet tjera publike, përfshirë legjislacionin. Gjithashtu, ligji duhet të definojë koordinimin e politikave me akterët relevantë, gjegjësisht me presidencën dhe me zyrën e kryeministrit.

Për rritjen e mëtutjeshme të llogaridhënies, ministria duhet ta rirregullojë qasjen ndaj emërimeve, të cilat duhet t'i zbatojnë rregullat e emërimeve bazuar në merita; t'i bëjë më kredibile testet dhe intervistat për punësime të reja, duke i kufizuar mundësitë për ndërhyrje. Në veçanti, duhet të përfundojë menjëherë praktika e emërimit të konsujve të pakualifikuar, joktivë dhe pa ndonjë portofol. Mirëpo, gjatë tranzicionit sistemi duhet të lejojë që të emëruarit "politik" ekzistues të kenë të drejtën e kalimit në diplomat të karrierës nëpërmjet një mekanizmi rigoroz të testimit. Nga ana tjetër, kjo gjë kërkon ristrukturimin e komisionit për vlerësim dhe gradim, dhe një definim më të mirë të kritereve të promovimit. Ministria duhet ta themelojë një inspektoriat për mbikëqyrjen e ambasadave dhe departamenteve, ta fuqizojë zyrën e drejtorit të përgjithshëm dhe ta reduktojë rolin e sekretarit të përhershëm. Për ta fuqizuar efikasitetin e politikës së jashtme, ministria duhet të vendos një sistem që mundëson një rotacion të shëndetshëm, nga grupet e ekspertëve dhe akademia nëpër misione diplomatike, gjë që do të ndihmonte në nxitjen e debateve cilësore brenda dhe jashtë vendit, rreth çështjeve të politikës së jashtme.

Mungesa e llogaridhënies publike në ministri përkon drejtpërdrejt me ndërhyrjen në ato që supozohet të jenë procedura të emërimit të paanshëm meritokratik. Kjo nga ana tjetër e ka rrezikuar seriozisht rolin e Akademisë Diplomatike dhe aftësinë e saj për të prodhuar diplomatë kompetent. Fuqizimi i akademisë duhet të jetë me rëndësi jetike, në mënyrë që ajo të përfshihet përsëri në një strategji të menduar mirë të politikës së jashtme. Në esencë, ministria duhet të rrisë buxhetin e akademisë duke kërkuar mbështetje të donatorëve, në mënyrë që të zhvillojë programet e veta për ngritje të kapaciteteve. Partneriteti me universitete dhe institute vendore mund të rezultojë i dobishëm për ngritjen aq të nevojshme të kapaciteteve dhe të rezultateve nga trajnimet e akademisë.

[82] Intervistë e Grupit për Ballkan, zyrtari i MPJ, Prishtinë, tetor 2019

[83] Kjo do të duhej ta zëvendësonte Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës (janar 2008), që është në fuqi aktualisht

Qeveria e re duhet të lancojë një rishqyrtim dhe vlerësim gjithëpërfshirës të politikës së jashtme. Rishqyrtimi do t'i analizonte prioritetet e politikës së jashtme të vendit, por edhe performancën e shërbimit diplomatik, bashkë me vlerësimin kadrovik të korit diplomatik në të gjitha nivelet. Fundja, kjo duhet të shërbejë për rifokusimin e politikës së jashtme, duke i dhënë asaj një qëllim dhe objektiv të qartë, i cili do t'iu kontribuoj përfitimeve afatgjata për shtetin dhe statusin e tij. Për këtë synim qeveria mund të kërkojë mbështetjen e shteteve mike me përvojë të mirë në këtë fushë, si Zvicra, Austria, Finlanda, Norvegjia, Estonia, etj.

Numri i ambasadave duhet të rritet me shpejtësinë e njëjtë me të cilën ministria arrin t'i përçojë burimet dhe stafin drejt tyre, në koordinim me një sistem informimi të përcaktuar qartë, në të cilin vijat e vartësisë përcaktohen drejtë, nga ambasadori drejt zyrës së caktuar rajonale në Prishtinë. Secila nga këto zyra pastaj do ta centralizonte politikën e vendit ndaj kontinenteve apo rajoneve specifike (për shembull, Afrika, Amerika Latine dhe Lindja e Mesme). Kjo, së bashku me qasjen e re për përkrahjen e diplomatëve të karierës, do të kontribuonin në luftimin e fushatës së "çnjohjeve" dhe në sqarimin e statusit ndërkombëtar të Kosovës. Tek e fundit, më e vështirë është ta «çnjohësh" një shtet që sillet si shtet sovran dhe i cili e ka të themeluar një mision diplomatik në kryeqytetin tënd.

Në Evropë, dhe në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Integrimeve Evropiane, ministria e jashtme duhet ta ketë prioritet hapjen e ambasadave në shumicën - nëse jo në të gjitha - e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Kjo jo vetëm që do ta lejonte lidhjen me qeveritë respektive të atyre vedeve dhe hapjen kanaleve të komunikimit, por edhe do të kontribuonte në komunikimin me vendet anëtare që nuk e kanë njohur Kosovën, si dhe do të ofronte një platformë për vendin që të provojë të ndikojë në proceset e vendimmarrjes në BE, nga të cilat vendi është aq i varur (sikurse u pa nga procesi i liberalizimit të vizave).

Bazuar në dimensionin ndërkombëtar të dialogut me Serbinë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me të, përfshirë këtu tarifat ndaj mallrave serbe, që nxitën reagime të shpeshta nga BE, SHBA., Gjermania dhe të tjerët për heqjen e tyre, ministria duhet të luaj rol më aktiv në artikulimin e një rrugëdaljeje. Në fakt, Ministria e Punëve të Jashtme duhet të bëhet pjesë e integruar e debatit të brendshëm, dhe të sigurojë informacione gjithëpërfshirëse për vendimet që marrin qeveritë. Kjo duhet bërë për të shmangur vendimet, shpeshherë të ngutshme, që kanë ndikim apo që shkaktojnë dëme diku tjetër, në veçanti në reputacionin e vendit ndërkombëtarisht. Ministria duhet të bëhet vlerësuese e një politike të brendshme me përfitim në aspektin ndërkombëtar, pozita e së cilës i kontribuon formimit të politikave në vend.

REKOMANDIME:

- Trajtoni me prioritet të lartë Politikën e Jashtme, përmes rritjes së buxhetit, të shoqëruar me një **zgjerim të konsiderueshëm të rrjetit të ambasadave**, që synim kanë të gjitha shtetet anëtare të BE-së, rajonet kryesore në Afrikë, Azi dhe Amerikën Jugore, të strukturuara përmes një "**desk system**" të shpërndarë, i cili do të mbulojë kontinentet dhe rajonet kryesore, që d.m.th Lindja e Mesme, Amerika Jugore, Lindja e Largët, etj;
- Ndërmerrni një **Rishikim gjithpërfshirës** të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Diplomatik për të identifikuar zbraztësitë dhe nevojat; kërkoni mbështetje nga shtetet mike dhe ekspertët vendorë për këtë proces;
- Rishqyrtoni dhe ri-iniconi **draft-ligjin për Ministrinë e Jashtme**, me fokus fuqizimin e ministrisë, rritjen e llogaridhënjes dhe përgjigjësive, kualitetin e Shërbimit Diplomatik, koordinimin dhe vlerësimin;
- Investoni në mekanizmat për lehtësimin e **koordinimit, shkëmbimeve dhe diskutimeve** me zyrat diplomatike;
- Fuqizoni rolit e **Akademisë Diplomatike** për një përgatitje më të mirë të stafit diplomatik në fusha të ndryshme, në mënyrë që **Shërbimi Diplomatik të profesionalizohet;** trajnimet të bëhen të detyrueshme, e vlerësimet më të rrepta;
- Themeloni **inspektoratin** për Shërbimin Diplomatik dhe Ministrinë, i cili duhet të ngarkohet me vlerësimin e performancës dhe llogaridhënjes së diplomatëve dhe shërbyesve civilë;
- Vendosni një **proces të transferimit**, për "të emëruarit politikë" në diplomatë karriere, nëpërmjet të vlerësimeve rigoroze;
- Ministria e Punëve të Jashtme të bëhet **pjesë integrale e diskutimeve politike** në vend, në mënyrë që të ndihmojë në vlerësimin e politikave, përfitimin apo dëmit nga politikat e caktuara dhe në shmangien e përplasjeve në mes politikave të brendshme dhe të jashtme.

DREJTËSIA

Strukturimi i refromave në kuadër të Rishikimit Funksional të sektorit të Sundimit të Ligjit

Gjyqësori mbetet i dobët, i rrënuar nga paaftësia, politizimi dhe korrupsioni në të gjitha nivelet; gjykatësit, prokurorët dhe stafi administrativ. Gjatë dekadës së fundit është investuar shumë në përmirësimin e performancës së tij. Vetingu i gjykatësve dhe i prokurorëve u zhvillua në vitin 2009, paketa e ligjeve të reja hyri në fuqi, gjykatat u riorganizuan me qëllim të realizimit të praktikave më të mira, dhe u fuqizuan kodet penale.[84] Në vitin 2018, BE-ja u pajtua që ta zvogëlojë praninë e EULEX-it, ndërsa qeveria inicioi dy nismat më të rëndësishme, Rishikimin Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit dhe Drejtësisë 2020.[85] Që nga viti 2016 Kosova është përkushtuar në fuqizimin e Sundimit të Ligjit dhe në luftën kundër korrupsionit, po ashtu nëpërmjet veprimeve kryesore të ERA-s; aty përfshihet edhe legjislacioni i ri për çështje të tilla si suspendimi i zyrtarëve publikë të paditur apo të dënuar për korrupsion, dhe parandalimi i konfliktit të interesit. Mirëpo, pjesët e tjera, si Kodi i Procedurës Penale që u përmend më lartë, u vonuan dhe nuk u miratuan shkaku i zgjedhjeve të shpeshta të parakohshme.[86] Po ashtu, ERA ka paraparë edhe një rishikim dhe riorganizim të institucioneve, agjencive dhe organeve të pavarura. Shikuar nga aspekti gjyqësor, ERA përfshin fuqizimin e departamentit ekonomik dhe divizionin e politikave fiskale në departamentin administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si dhe rritjen e kapaciteteve të Zyrës së Prokurorit Special.[87] Kohëve të fundit, numri i gjykatësve dhe prokurorëve është rritur ndjeshëm.[88] Menjëherë pas Marrëveshjes me Serbinë gjyqësori fillimisht integroi 40 gjykatës dhe 13 prokurorë, por edhe stafin administrativ nga radhët e komunitetit serb në Veri, duke rithemeluar kështu gjykatat në territorin e katër komunave veriore.[89]

Këshilli gjyqësor (KGJK) dhe ai prokurorial (KPK) mbeten tejet të paaftë, ngase iu mugojnë kapacitetet bazike administrative. Ata dështojnë të veprojnë me përgjegjësi, t'i zbatojnë rregulloret dhe standardet e etikës, dhe hezitojnë në mbajtjen përgjegjës të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit jogjyqësor.

---

[84] Gjatë dy viteve të fundit disa ligje të reja kanë hyrë në fuqi, me qëllim të riorganizimit të sistemit juridik dhe të aplikimit të ligjit. Këtu përfshihet Kodi Penal për të Mitur (tetor 2018), Ligji për Noterinë (dhjetor 2018), Ligji për Këshillin Gjyëqësor të Kosovës (dhjetor 2018), Ligji për Kodin Penal (janar 2019), Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës (prill 2019). Pjesët më të vjetra të legjislacionit që ende janë në fuqi përfshijnë Ligjin për Zyrën e Prokurorisë Speciale (qershor 2008), Ligjin për Procedurat Kontestimore (shtator 2008), Ligjin për Procedurat e Kontestuara (janar 2009), Ligjin për Konfliktet Administrative (tetor 2010), Ligjin për Prokurorin e Shtetit (tetor 2010), Ligjin për Procedurat e Kodit Penal (korrik 2012), Ligjin për Procedurën e Zbatimit (janar 2013), Ligjin për Provimin e Avokatisë (maj 2013), Ligjin për Avokatinë (maj 2013), dhe Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (gusht 2013)..

[85] Rishikimi Funksional fillimisht u lancua në vitin 2016, sipas Vendimit të Qeverisë nr. 07/117, nëntor 2016, ndrësa Drejtësia 2020, që u lancua në vitin 2018, "pritet t'i përcaktojë prioritetet afatshkurtëra, veçanërisht ato që rrisin efikasitetin e gjyqësorit, në përputhje me rezultatet e dala nga Rishikimi Funksional, nga intervista e Grupit për Ballkan, zyrtar i MPJ, Prishtinë, 2 dhjetor 2018

[86] Kodi i Procedurës Penale e kaloi leximin e parë më 5 maj 2019, por që nga ajo kohë ka mbetur i bllokuar. Procesi ligjor është i qasshëm në http://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaë=176

[87] Për më tepër shih Grupin për Ballkan, Agjenda për Reformat Evropiane: *Raporti i progresit për qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit [European Reform Agenda Good Governance and Rule of Law Progress Report],* Prishtinë, tetor 2017, f. 20 dhe 21, në https://balkansgroup.org/blog/post/publications/european-reform-agenda-progress-report-good-governance-and-rule-law

[88] Më 2010, pas procesit te vetingut, mbetën 246 gjykatës aktivë; në fund të viti 2018 ky numër shkoi në 352. Shifrat janë nga OSBE, *Përbërja gjinore e gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë [Gender Composition of judges and prosecutors in Kosovo]*, Pristinë, dhjetor 2010, dhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Statistikat e Gjykatave, Raport Vjetor 2018*, Prishtinë, 2019

[89] Në fazën e parë të zbatimit të Marrëveshjeve të Brukselit, 40 gjykatës dhe 13 prokurorë të sistemit parelel serb janë integruar në gjyqësor. Për më shumë shih EULEX, *Raporti Kompakt i Progresit, Vlerësimi i Progresit në periudhën korrik 2017-qershor 2018[Compact Progress Report, Assessing Progress Between July 2017– June 2018]*, në https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/106075-CPR-2018-En.PDF dhe në Kosovo Serbia Policy Advocacy Group *Përshtypjet e mia për integrimin e gjyqësorit në veri [My Impressions of the Integration of the Judiciary in the North]*, editorial, 8 nëntor 2019, në https://balkansgroup.org/blog/post/articles/my-impressions-integration-judiciary-mitrovica

Përderisa administratat e tyre performojnë dobët, donatorët vazhdojnë t'i mbështesin kërkesat e tyre themelore. Qoftë edhe për vlerësimin e nevojave të stafit para angazhimit të punësimeve të reja, KGJK vazhdimisht është mbështetur në përkrahjen dhe ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare.[90] Shqyrtimet e performancës janë sipërfaqësore dhe formale, mirëpo falë kërkesave të ulta është praktikisht e pamundur që ato të dështojnë. Nevojat e personelit shpeshherë vlerësohen keq, ndërkohë që administrata gjyqësore është rritur në masë të konsiderueshme, duke trashëguar mangësitë drastike të kapaciteteve. Njëkohësisht, numri i madh lëndëve të vjetra, koha e gjatë për sistemimin e lëndëve të reja dhe mungesa e ekzekutimit të dënimeve, mbesin shqetësim i madh.

Ligjërisht, qeveria është e kufizuar në ndikimin e saj në punët e përditshme të gjykatave dhe prokurorisë. Megjithatë, qeveria duhet ta rindërtojë besimin tek gjyqësori, të përkushtohet që të mos ndërhyjë ose ushtroj presion të padrejtë, por edhe që t'i zbatojë ligjet, rregullat dhe standardet, në mënyrë që anëtarët e gjykatave dhe prokurorisë t'i bëjë shumë më efikas dhe më të përgjegjshëm. Ndërhyrja politike në gjyqësor është një realitet, edhe pse shumëkush brenda sistemit gjyqësor është i kënaqur që mban lidhje me politikanët, të cilët s'kërkojnë asnjë përgjegjësi prej tyre, dhe as nuk ofrojnë ndonjë mbështetje domethënëse. Kjo është vetëm njëra anë e tregimit. Tjetra ndodhet brenda vetë sistemit; në koordinim të ngushtë me KGJK-në dhe KPK-në qeveria duhet të insistojë në miratimin dhe vendosjen e standardeve shumë më të larta për gjykatat dhe anëtarët e gjyqësorit.

Qeveria e re duhet të rinis punën në Rishikimin e vonuar Funksional, ta bëjë atë më gjithëpërfshirës, dhe ta avancojë me prioritet. Rishikimi Funksional përbëhet nga tri komponenta, të ndara në 7 shtylla.[91] Komponenta e parë do ta rishikojë kornizën ligjore, e dyta do ta analizojë strukturën institucionale dhe legjislacionin, dhe e treta do ta analizojë bashkëpunimin ndërmjet të gjitha organeve gjyqësore. Ky proces ka shkaktuar pritje të mëdha për adresimin sistematik të shumë mangësive të gjyqësorit. Në këto kufizime përfshihen përgjegjësia, performanca e gjykatësve dhe prokurorëve, numri i gjykatësve, mungesa e trajnimit të stafit administrativ. Themelimi i një sistemi modern të bashkëpunimit dhe përcjellja e çështjeve ndërmjet prokurorit, policisë dhe gjykatave paraqet një rrugë të gjatë për rritjen e përgjegjësisë. Po ashtu, nevojitet një ndërhyrje edhe për fuqizimin e lidhjes ndërmjet gjykatave dhe agjencive tjera për zbatimin e ligjit (kryesisht Policisë së Kosovës), dhe për sigurimin e asaj që vendimet gjyqësore të kenë efekt në jetën e qytetarëve. Nxitja për vlerësime më të rrepta të performancës vjetore dhe rritja e buxhetit për KGJK-në dhe KPK-në, për përmbushjen e detyrave të tyre, janë kompetencë e qeverisë. Paralelisht, qeveria duhet t'i miratojë ligjet e reja, të cilat duhet të dalin nga Rishikimi Funksional, dhe t'i mbështesë Këshillat në vendosjen e kontrolleve të detyrueshme dhe gjithëpërfshirëse, përmes një sistemi të "vlerësimit të integritetit" të të gjithë anëtarëve të gjyqësorit, përfshirë këtu edhe rekrutët e rinj. [92]

[90] "Ne nuk kemi kapacitete për t'i vlerësuar nevojat tona për 5-10 vite. Ne nuk dimë si ta bëjm këtë… nëse ia kërkojmë gjykatës, ata do të japin një listë… na duhet të mbështetemi tek amerikanët", Intervistë e Grupit për Ballkan, antëar i KGJK, Prishtinë, shtator 2017

[91] Shtatë shtyllat janë 1) Konsolidimi i kornizaës ligjore dhe asaj institucionale për t'i avancuar parimet e Sundimit të Ligjit 2) Funksionimi i gjyqësorit 3) Transformimi i sistemit penal 4) Avancimi i mekanizmit për qasje ne drejtësi 5) Roli i partnerëve dhe donatorëve 6) Masat kundër korrupsionit 7) Drejtësia tregtare. Vendimi i Qeverisë Nr. 24/2018, Prishtinë, shkurt 2018

[92] Sipas Rishikimit Funksional, një përshkrim politikash është zhvilluar me qëllim të studimit të praktikave më të mira të kontrolleve të integritetit, duke ofruar një sërë rekomandimesh, e me qëllim të fuqizimit të KGJK-së dhe KPK-së.

Kosova dhe institucionet e saj duhet të ecin përpara me reformat, t'i mbështesin programet dhe nismat e tjera. BE-ja do t'i fillojë së shpejti nismat më të reja për Sundimin e Ligjit; e para, që do të kapë vlerën e 9 milionë eurove, tashmë është në proces. [93] Qeveria, e mbështetur nga Ministria e Integrimeve Evropiane dhe ajo e Drejtësisë, duhet të shndërrohet në pikë qendrore të koordinimit të politikave dhe për nisma për Sundimin e Ligjit. Kosova do të ketë nevojë për mbështetje të vazhdueshme dhe donatorët janë të gatshëm ta ofrojnë atë; qeveria dhe institucionet e tjera të Sundimit të Ligjit duhet ta kërkojnë mbështetjen për përmbushjen e nevojave, por edhe për rritjen e standardeve të performancës dhe të qasjes që qytetarëve në drejtësi.

Një çështje tjetër specifike që kërkon veprim të menjëhershëm është edhe dhuna mbi baza gjinore. Gratë, por edhe anëtarët e komunitetit LGBTQ+, vazhdojnë të përballen me dhunë dhe me forma të ndryshme të diskriminimit.[94] Në vitin 2018, policia pranoi 1692 raportime të dhunës në familje, 238 raporte të krimeve kundër integritetit seksual dhe 94 për krime kundër martesës dhe familjes.[95] Megjithëse raportimet po rriten gradualisht nga viti në vit, ende ekziston një mungesë e theksuar e raportimeve, që pastaj i kontribuon ndjenjës së pandëshkueshmërisë, gjë që kultivohet edhe nga zakonet kulturore dhe sociale. [96] Qeveritë e kaluara filluan luftimin e këtij fenomeni, përmes prezantimit të trajnimeve specifike mbi këtë çështje për zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe të prokurorisë, por edhe për gjykatës. Strategjia Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, e miratuar në vitin 2016, parashikon një numër veprimesh që bazohen në 4 shtylla; në parandalimin dhe ngritjen e vetëdijes, në mbrojtje e koordinim, në legjislacion, hetim e procedim, dhe në rehabilitim e integrim.[97] Implementimi, sikurse edhe tek shumë strategji të tjera, ishte i mangët. [98]

Një çështje tjetër që do të jetë e vështirë për qeverinë e re është mandati i Dhomave të Specializuara, ftesat për intervistim dhe aktakuzat e mundshme për ish-pjesëtarët e lartë të UÇK-së.[99] Dhomat e Specializuara e filluan punën në vitin 2015 dhe Vetëvendosje që nga fillimi ishte kundër themelimit të tyre.[100] Funksionimi i Dhomave dhe i Zyrës së Prokurorit Special, struktura dhe mandati, përcaktohen me Kushtetutë dhe ligj.[101] Një bazë e gjerë ligjore rregullon këtë institucion të "diskutueshëm", megjithëse debati rreth bazës ligjore për vazhdimin e funksionimit dhe kohëzgjatjen e mandatit të Dhomave i ndan ekspertët dhe anëtarët e institucioneve kryesore vendore nga ata të Administratës Publike dhe

[93] Nismat kryesore të Sundimit të Ligjit do t'i zgjerojnë mjetet e asistencës ekzistuese dhe ato alternative, dhe do të prezantojnë mekanizma të ri të mbështetjes, përfshirë misionet këshilluese për Sundimin e Ligjit dhe misionet e rasteve specifike që bazohen në ndërmjetësim apo edhe monitorim të seanacave gjyqësore dhe në zhvillimin e planeve të detajuara të veprimit dhe të indikatorëve, shih Komisioni Evropian, *Një perspektivë e besueshme e zgjerimit [A Credible Enlargement Perspective]*, 2018

[94] Komisioni Evropian, *Kosovo* 2019 Report*, 2019, f. 28

[95] Statistika e plotë lidhur me rastin mund të gjindet në uebfaqen e Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut, në http://www.cshr-ks.org/en/kosovo-police/?v=2018&id=1

[96] Instituti Kosovar për Shqyrtim të Politikave dhe Zhvillim, *Qasja në drejtësi për viktimat e dhunës mbi baza gjinore në Kosovë: Përfundimi i pandëshkueshmërisë për kryerësit [Accessing Justice for Victims of Gender Based Violence in Kosovo: Ending Impunity for Perpetrators]*, dhjetor 2018, f. 6, në https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/accessing_justice_for_victims_of_gender_based_violence_in_kosovo_eng.pdf

[97] Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrotjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016–2020, Prishtinë, maj 2016, në https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ%20/Strategjia%20Komb%C3%ABtare%20e%20RK%20p%C3%ABr%20mbrojtje%20nga%20dhuna%20ne%20familje%202016-2020(1).pdf

[98] Përderisa korniza ligjore është pothuajse e gatshme, mbrojtja e viktimave dhe hetimi dhe dënimi i sulmuesve mbeten problematike, për shkak të mungesës së fondeve dhe të implementimit rutinor. Për shembull, gjykatësit dhe prokurorët i janë nënshtruar një trajnimi për këtë temë, mirërpo këto raste shpeshherë u janë ndarë personave të patrajnuar. Shih KIPRED, *Qasja në drejtësi [Accessing Justice]*, dhjetor 2018, f. 25

[99] Për më shumë informata shih Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian lidhur me Misionin Evropian të Sundimit të Ligjit në Kosovë, në https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11213

[100] Kurti ka qenë kundër Dhomave të Specializuara që nga inicimi i tyre, të cilat ka thënë se nuk i bëjnë asnjë të mirë vendit. Shih RTV21, *Kurti: Institucionet e Kosovës janë poshtëruar me hapjen e Gjykatës Speciale,* 3 gusht 2018, në http://rtv21.tv/kurti-me-hapjen-e-rruges-per-gjykaten-speciale-u-poshteruan-institucionet-e-kosoves/

[101] Neni 162, Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit Special, (gusht 2015)

Dhomave të Specializuara.[102] Nëse vitin e ardhshëm kërkohen ndryshime ligjore, qeveria do të duhet të gjejë një konsensus për miratimin e atyre ndryshimeve, në veçanti nëse ndonjë amandamentim kërkohet nga Gjykata Kushtetuese. Deri para verës së vitit të ardhshëm poblemi mund të shndërrohet në një çështje për interpretim nga ana e Gjykatës Kushtetuese.[103] Përveç nga interpretimet juridike, qeveria duhet të përmbahet edhe nga sulmet ndaj Dhomave. Qëllimi përfundimtar duhet të jetë mbështetja e këtij procesi dhe përmbyllja e punës së tij sa më parë që të jetë e mundur. Në një skenar ideal të së ardhmes, Kosova do të mund të kërkojë zhvendosjen e Dhomave të Specializuara, dhe t'iu lejojë atyre operimin brenda vendit. Kjo gjë mund të ndodhë vetëm po qe se bëhen avancime të mëdha në fushën e Sundimit të Ligjit, përfshirë këtu mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ekzekutimin e urdhrave të gjykatës.

REKOMANDIME:

- Mbeshtetni plotësisht **Rishikimin Funksional dhe Drejtësinë 2020**, zgjeroni gamën e reformave me qëllim të bërjes së përmirësimeve të mëdha, ngritjes së standardeve të **përgjegjësisë** për institucionet gjyqësore, gjykatësit dhe prokurorët, përfshirë këtu rritjen e numrit të tyre. Inkurajoni dhe mbështetetni KGJK-në dhe KPK-në në reformmimin e statusit të **administratës gjyqësore** dhe **stafit administrativ** që punon në gjykata dhe në prokurori. Ky proces duhet të marrë mbeshtetjen e plotë politike, ndonëse duhet të udhëhiqet nga zyrtarë civil dhe të përmbyllet pa vonesa të reja;
- Në koordinim të ngushtë me KGJK-në dhe KPK-në, të bëhen ndryshimet e nevojshme ligjore për të siguruar **vlerësim të vazhdueshëm** të të gjithë anëtarëve të gjyqësorit, prokurorëve, gjykatësve, stafit profesional dhe administrativ; forconi testin e performancës **vjetore** për të gjitha nivelet e gjyqësorit;
- Miratoni pa vonesë **Kodin e Procedurës Penale**;
- Fuqizoni i **koordinimin** ndërmjet gjykatave, prokurorisë dhe policisë;
- Merrni përgjegjësinë dhe fuqizoni rolin e Ministrisë së Drejtësisë, për **koordinimin** e të gjitha nismave dhe projekteve në fushën e Sundimit të Ligjit, në bazë të **vlerësimeve gjithëpërfshirëse të nevojave** dhe objektivave të qarta të përcaktuara me Rishikimin Funksional;
- Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Punëve të Brendshme duhet të koordinohen, për të rritur më shumë **ndjeshmërinë institucionale** ndaj **dhunës mbi baza gjinore dhe asaj në familje**;
- Mbështetni vazhdimin e punës së **Dhomave të Specializuara** dhe ndërtoni raporte të mira me partnerët dhe me opozitën, për të miratuar kështu ndryshimet ligjore nëse është e nevojshme, dhe angazhohuni me SHBA-në, BE-në dhe shtetet anëtare për përcaktimin e një afati zyrtar për mandatin e Dhomave, i cili nuk e kufizon punën e tyre por edhe nuk i lë ato me mandat tërësisht të hapur.

[102] Avokati, Dastid Pallaska, e konsideron konfuzionin dhe dykuptimësinë brenda tekstit si mënyrë se si bashkësia ndërkombëtare po përpiqet që ta kalojë gjykatën te deputetët, shih lajmi.net, *A po i skadon mandati gjykatës speciale?,* 25 nëntor 2019, në https://lajmi.net/a-po-i-skadon-mandati-gjykates-speciale/

[103] Intervistë e Grupit për Ballkan, anëtarët e qeverisë dhe të Vetevendosjes, Prishtinë, tetor 2019

ARSIMI

Një urgjencë kombëtare për rritjen e kualitetit të mësimit

Kualiteti i arsimit mbetet njëri prej shqetësimeve kryesore të qytetarëve; kjo u dëshmua edhe nga debati intensiv mbi këtë temë gatë fushatës zgjedhore. Sistemi i arsimit publik ka qenë gjithmonë subjekt dyshimi; me infrastrukturë të dobët, akuza për nepotizëm dhe joprofesionalizëm, njohje të kufizuar të diplomave dhe certifikatave, mungesë të madhe të resurseve dhe një përqindje alarmuese e braktisjes së shkollës, që të gjitha këto i kontriibuojnë uljes së prestigjit të institucioneve të arsimit dhe nivelit të ulët të besimit në to.[104] Goditja më e rëndë ndaj sistemit erdhi në vitin 2016, kur OECD për herë të parë e përfshiu Kosovën në vlerësimet e saj, që njihen si PISA.[105] Rezultatet ishin shkatërruese, ngase Kosova u radhit në mesin e tre më të dobëtve në botë.[106] Testi nxori rezultate të ngjashme për arsimin e Kosovës në fillim të dhjetorit 2019, duke treguar kështu se, edhe pse pati shumë premtime për përmirësim, në fakt nuk është arritur pothuajse asgjë.[107]

Sfida kryesore me të cilën po përballet sistemi arsimor është kualiteti i dobët i punjonësve të tij, veçanërisht i mësimdhnënësve dhe administratatorëve. Ekziston një sistem licencimi për mësimdhënës, i cili teorikisht e rregullon inkuadrimin e tyre në profesion dhe përtrirjen periodike, bazuar në trajnim të vazhdueshëm. Mirëpo, përpilimi i tij ka zgjatur me vite të tëra dhe vetëm së fundmi është përfunduar korniza e tij normative.[108] Për më keq, buxheti i alokuar për trajnime nga Ministria është zvogëluar, gjë që ka shpier në situatën ku trajnimi i vazhdueshëm është bërë i detyrueshëm, por jo edhe i realizueshëm për të gjithë mësimdhënësit. Si rezultat, theksi është vënë në certifkimin e orëve të trajnimit, në vend se në fitimin e njohurive ose aftësive të mësimdhënësve.[109]

Vetëvendosja, por edhe LDK kanë premtuar se do ta rrisin buxhetin për arsim; një kërkesë kjo e domodoshme për përmirësimin e kualitetit të përgjithshëm të sistemit. Mirëpo, Ministria e Arsimit duhet ta përpilojë një plan të detajuar për një buxhet më të madh. Investimet e shtuara janë të padobishme po qe se institucionet arsimore nuk i përdorin ato. Ministria është ndër institucionet më të dobëta në vend, ka një performancë të ultë, është tepër e korruptuar dhe posedon planifikues dhe zyra strategjike jokompetente.[110] Asaj i duhet një ristrukturim dhe vlerësim jashtëzakonsht i madh i stafit. Për më tepër, planifikimi dhe rritja e buxhetit duhet të koordinohen me donatorë të ndryshëm, të cilët e përkrahin vazhdimisht sistemin arsimor. Financimi duhet të ndjekë një vlerësim specifik të nevojave, për t'u siguruar se paratë arrijnë efekt tek nxënësit.

Qeveria Mustafa kishte aprovuar një Plan Strategjik të Arsimit 2017-2021.

---

[104] Kosovo 2.0, *Si të reregullohet një sistem i thyer [How to fix a broken system]*, 25 maj 2017, në https://kosovotwopointzero.com/en/big-election-issues-education/

[105] PISA, që dmth Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve, e matë aftësinë e nxënësve 15-vjeçarë nga më shumë se 80 shtete të botës, në fushat e matematikës, shkencës dhe leximit.

[106] OECD, *PISA: Rezultatet* në fokus [*PISA: Results in focus]*, Paris, dhjetor 2016, f. 5, në http://www.oecd.org/pisa/pisa-2015-results-in-focus.pdf

[107] Kosova ende radhitej e treta nga fundi në testin e PISA-s të vitit 2018, dhe ajo aktualisht rezultoi më keq në shkencë sesa në vitin 2015, për më shumë, shih Pristina Insight, *Fotografia shqetësuese e rezultateve të PISA-s [PISA Results Paint Dispiriting Picture]*, 3 dhjetor 2019, në https://prishtinainsight.com/pisa-results-paint-dispiriting-picture/

[108] Rrjeti i Kosovës për Edukim dhe Punësim, *Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë,* prill 2019, f.26

[109] *Ibid.*

[110] Intervistë e Grupit për Ballkan, zyrtarët e Zyrës për Planifikim Strategjik dhe Donatorë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, tetor 2019

Kjo strategji afatmesme që synonte përfshirjen e planifikimit sektorial në arsim, në mënyrë që të sigurojë një politikë koherente të bazuar në shtatë (7) Qëllime Strategjike. Këto qëllime fillojnë nga më të përgjithshmet (përfshirja e minoriteteve dhe grupeve të rrezikuara) vazhdojnë me ato operative (menaxhimi i sistemit dhe zhvillimi i mësimdhënësve) dhe perfundojnë me ato më specifiket (rregullorja mbi trajnimet profesionale dhe arsimin e lartë). [111]

Në arsimin parashkollor plani identifikon një zbraztësi të madhe, meqë pothuajse një e treta e komunave ende nuk e kanë një institucion parashkollor publik. Jo vetëm kaq, por edhe institucionet private punojnë me fare pak ose pa mbikëqyrje, gjë që rezulton me një kualitet të dobët të shërbimeve të ofruara, duke lënë kështu shumë nxënës të moshës parashkollore pa qasje në çerdhe.[112] Sa i përket arsimit bazë (atij fillor dhe të mesëm), edhe aty vërehet se programet mësimore janë shumë të vjetruara, dhe dështojnë në përgatitjen e nxënësve për jetë pas shkollimit. Kjo pastaj ka pasoja të mëdha për nxënësin, njohuritë e të cilit nuk mjaftojnë për një vend pune; po ashtu, ka pasoja edhe për shtetin, sepse fuqia punëtore është e pakualifikuar dhe joproduktive.[113]

Këto probleme janë edhe më të shprehura në sektorin e Arsimit dhe Trajnimit Profesional (ATP), ku sistemi është i paqartë dhe i mungon konsolidimi. Për shembull, përkundër miratimit të Strategjisë ende nuk ekziston një Kurrikulë specifike bazë për ATP andaj, si rrjedhojë, ATP nuk u përfshi fare në Kornizën Kombëtare të Kurrikulave, që rezultoi me një status të paqartë të të diplomuarve.[114] Me përjashtimin e definimit të qartë të programeve dhe përmbajtjes së tyre, profesorëve nuk iu mbeti asnjë material në dispozicion dhe, në mënyrë të ngjashme, atyre nuk mund t'iu ofrohej asnjë trajnim i vërtetë i cili, nëse kombinohet me mungesën e trajnimeve praktike, e kufizoi në mënyrë të dukshme përfitimin e sistemit karshi tregut të punës.[115] Historikisht, ATP ka pasur pak rëndësi, ngase cilësohej njëlloj destinacioni për nxënës të dobët, që dështmohet edhe nga trajtimi i tij nga institucionet publike. Kjo gjendje duhet të ndryshojë, andaj përpjekjet e reja për përmirësimin e arsimit nuk duhet ta lënë anash Edukimin Profesional. Përmbajtja e Strategjisë dhe Planit të Veprimit duhet të zbatohen.

Por, nuk është problemi këtu vetëm tek arsimi bazik. Qeveria Haradinaj la një trashëgimi shqetësuese në arsimin e lartë. Ndërhyrja e saj, në shtator të vitit 2017, në Agjencinë Kosovare të Akreditimit (AKA) dhe shkarkimi i ushtruesit të detyrës së drejtorit dhe i gjithë bordit (që ishte ndër veprimet e para të qeverisë) rezultoi me përjashtim të menjëhershëm nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR).[116] Veprimet e saj, qeveria ia atribuoi pretendimeve për korrupsion brenda bordit dhe performancës së dobët. Sido që të jetë rasti, Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) e degradoi statusin e AKA-s në atë të "Anëtarit në Rishqyrtim", derisa pas vlerësimit pasues përfundimisht e përjashtoi atë, në tetor 2019. [117]

---

[111] Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Plani Srategjik Arsimor i Kosovës 2017–2021*, Prishtinë, korrik 2016, në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/KOSOVO_EDUCATION_STRATEGIC_PLAN.pdf

[112] *Ibid*, p. 21

[113] Oda ekonomike e Amerikës në Kosovë, *Arsimi dhe tregu i punës në Kosovë dhe Bashkimi Evropian* [*Education and Labor Market in Kosovo and European Union]*, dhjetor 2018, në https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2019/ 02/ENG-Education-and-Labor-Market-in-Kosovo-and-EU.pdf

[114] Në fund të vitit 2019, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve ka përcaktuar vetëm pjesërisht kurrikulën, me një numër të kufizuar programesh. E njëjta është e qasshme në uebfaqe, në https://aaaparr.rks-gov.net/en/udhezime-administrative

[115] Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Plani Strategjik 2017–2021*, 2016, f. 81

[116] Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, *Përjashtimi nga regjistri i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) [Exclusion of the Kosovo' Accreditation Agency (KAA) from the Register]*, C22, 27 shkurt 2018, në https://backend.deqar.eu/reports/EQAR/2018-02_Exclusion_Decision_C22_KAA.pdf

[117] Letra e Christoph Grolimund, kryetar (ENQA) drejtuar Avni Gashit, ushrtrues detyre i drejtorit (AKA) lidhur me amtarësimin e AKA-së në ENQA, 1 tetor 2019, në https://enqa.eu/wp-content/uploads/2019/10/Letter-ENQA-to-KAA_Sep-2019.pdf

Këto ngjarje e vënë në dyshim sistemin e arsimit të lartë ngase, me humbjen e çfarëdo reputacioni që mund ta ketë pasur dhe me zhbërjen e shumë viteve të përpjekjeve të administratave të kaluara, tani ka mbetur jashtë rrjeteve pan-evropiane.

Pas këtyre zhvillimeve, arsimi i lartë i Kosovës ka bërë shumë hapa mbrapa. Korniza institucionale ekziston, por asaj tani i mungon mbulimi ndërkombëtar të cilin e kishte. Vlerësimi i ENQA-s përmban edhe një numër rekomandimesh shumë specifike për AKA-në, të cilat duhet të shndërrohen në udhërrëfyes dhe plan për organizimin e saj një të ardhmeje të afërt. Këto rekomandime duhet integrohen në Ligjin e ardhshëm për Arsimin e Lartë, i cili, edhe pse i përfshirë në Planin Legjislativ të qeverisë së kaluar, nuk arriti ta përfundojë procedurën parlamentare, kështu që mbeti i papërfunduar deri në fund të mandatit.[118] Qeveria e re duhet ta rishikojë këtë ligj, për t'u siguruar se i përgjigjet shqetësimeve të ENQA dhe EQAR. Për më tepër, Bordi i AKA-së dhe Ministria e Arsimit duhet të koordinohen për të implementuar secilin rekomandim, duke filluar nga Ligji i ri e deri te prezantimi i praktikave të reja, siç parashihet nëpërmjet rregulloreve ose udhëzimeve administrative, duke garantuar kështu pavarësinë e AKA-së.

Puna e Agjencisë duhet të bazohet në kritere të pastra teknike, pavarësisht interesave biznesore dhe përfitimeve politike. Është me rëndësi të mbahet mend se pavarësia e AKA-së në të gjitha fazat ishte faktori kryesor që ndikoi në rënien e saj, prandaj ministria në përpjekjen e saj duhet të ketë vetëm rol mbështetës. AKA duhet të dëshmojë se është në gjendje ta përmbushë mandatin e saj në mënyrë të pavarur, para se ENQA dhe EQAR të marrin në konsiderim ripranimin e saj. Për këtë arsye, në pritje të rikthimit të statusit të saj, AKA duhet ta shqyrtojë mundësinë e krijimit të partneriteteve me homologet evropiane, me qëllim të shkëmbimit të praktikave më të mira dhe thithjes së mbështetjes teknike për ngritjen e kapacitetevee.

[118] Shih procesin legjislativ në http://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=160

REKOMANDIME:

- Trajtoni me prioritet dhe zgjeroni **Reformat në Arsim**, me qëllim të rritjes së kualitetit të arsimit publik , rritjes së kualitetit të mësimdhënjes dhe pregatitjes së të rinjeve për **tregun e punës**;
- Rishikoni të gjitha dokumenteve strategjike, dhe vendosni prioritetin tek ndërtimi i **kapaciteteve dhe trajnimit** për mësimdhënësit e të gjitha niveleve, bëni programet e trajnimeve të detyrueshme dhe kërkoni mbështetjen e donatorëve për lancimin e **programeve të zgjeruara të trajnimit** për mësimdhënës gjatë muajve të verës;
- Rritni konsiderueshëm **buxhetin** për arsimin dhe fuqizoni **kapacitetet menaxhuese** për departamentet dhe administratorët përgjegjës nëpër shkolla dhe institucione arsimore, nëpërmjet trajnimeve të detyrueshme dhe rigoroze;
- Ndihmoni komunave që ta zgjerojnë shtrirjen e **arsimit parashkollor publik**, për të garantuar kështu shërbime adekuate në gjithë vendin;
- Trajtoni me prioritet **rishikimin e kurrikulave** për arsimin bazë, me ndihmën e organizatave apo qeverive kredibile ndërkombëtare, si psh me Finlandën, Austrinë, etj.
- Riprocedoni dhe rishikoni **Draft-ligjin për Arsimin e Lartë**, për t'u siguruar se ai është në përputhje **me rekomandimet e ENQA-s**;
- Fuqizoni dhe mbështetni **Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA)**, ftoni organizatat kredibile evropiane për mbështetjen dhe ndërtimin e kapaciteteve, rritjen e mbikëquerjes dhe konsolidimin e vendimmarrjes.

SHËNDETËSIA

Përmirësimi i shërbimeve dhe lancimi i skemës së sigurimit shëndetësor

Njësoj si arsimi edhe shëndetësia mbetet një fushë ku shërbimet publike mbesin tmerrësisht të pazhvilluara. Sipas Komisionit Evropian, një e pesta e popullsisë nuk mund të sigurojë kujdes shëndetësor për shkak të varfërisë, ndërsa pacientët mbulojnë 40 përqind të shpenzimeve të trajtimeve shëndetësore nga xhepat e tyre. [119] Si rrjedhojë, pjesa më e varfër e shoqërisë është e prekur joproporcionalisht, janë përjashtuar nga masat parandaluese dhe nuk kanë qasje tek protokolet e diagnostifikimit dhe trajtimit.

Sistemi është shkatërruar nga politizimi dhe akuzat për korrupsion. Ndryshimet e mëhershme në qeveri nxitnin beteja armiqësore ndëmjet partnerëve të koalicionit rreth kompetencave dhe investimeve, përderisa emërimet bëheshin në bazë të besnikërisë partiake, gjë që e bëri shërbimin jofunksional. Sistemi shëndetësor është i kapur nga interesat private.[120] Mjekët zakonisht punojnë në institucione publike dhe në ato private, gjë që krijon mundësi për abuzim.[121] Pacientët dërgohen në institucione private, ku aplikohet një tarifë e shtrenjtë.

[119] Komisioni Evropian, *Kosovo* 2019 Report*, 2019, f. 69

[120] Instituti i Kosovës për Demokraci, *Kapja e shtetit në Kosovë: Tregtimi i shëndetit publik për përfitime private [State Capture in Kosovo: Trading Public Health for private gain]*, prill 2018

[121] UNDP, *Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit në sektorin e shëndetësisë* në Kosovë *[Corruption Risk Assessment in the Health Sector in Kosovo]*, dhjetor 2014, në https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/SAEK/UNDP%20SAEK%20Corruption%20Risk%20Assessment%20in%20Health%20December%202014%20-%20Eng.pdf

Tutje, sistemi publik vuan nga ikja e kuadrove, ngase viteve të fundit një numër në rritje i profesionistëve emigruan për punë drejt vendeve te BE-së, në veçanti në Gjermani.[122] Ministri në largim i shëndetësisë alarmoi se trendi i ikjes do të vazhdojë, nëse kushtet e punës për mjekët dhe punonjësit e shëndetëtsise nuk përmirësohen dukshëm, përfshirë këtu edhe pagat.[123]

Ministria mbetet e dobët dhe asaj i mungojnë kapacitetet dhe vullneti për adresimin e këtyre çështjeve. Aftësimi i vazhdueshëm i mjekëve dhe modernizimi i teknologjisë është i domosdoshëm për ringjalljen e sektorit të shëndetësisë. Marrëveshjet bilaterale me qeveritë e BE-së po nënvlerësohen. Një shembull i mirë i këtij pohimi është një nismë e përbashkët me Qeverinë Çeke, ku dy nënshkruesit i ndanë shpenzimet për sjelljen e ekspertëve të huaj për trajtimin e pacientëve dhe trajnimin e mjekëve vendorë. Marrëveshja është nënshkruar në vitin 2012, por nuk është zbatuar asnjëherë, ngase ministria nuk shfaqi interesim për implementimin e saj.[124] Ka mjaft donatorë të gatshëm për mbështetjen e këtij sektori, por interesi vendor mungon shumë.

Këto projekte do të mund të përsëriteshin me shtetet që shquhen për fusha të specializuara, mirëpo, për ta bërë një gjë të tillë Ministria e Shëndetësisë duhet ta profesionalizojë administratën e saj. Qeveria e kaluar u përpoq deri në një masë, sepse u përqëndrua në ristrukturimin e shërbimeve të caktuara dhe në riorganizimin e menaxhimit të institucioneve shëndetësore, veçanërisht në prokurim publik dhe në praktikat e kontraktimit. Ajo i lejoi organizatat e shoqërisë civile që t'i monitoronin prokurimet, për të rritur kështu transparencën dhe për të krijimar një nivel të dytë të vlerësimit.[125] Ajo po ashtu publikoi një listë të barërave substanciale, e cila mungonte më parë.[126]

Kosova mbetet një shembull paradoksal në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë përgjithësisht, sepse vendit i mungon skema e sigurimeve shëndetësore publike. Në vitin 2014, Kuvendi e kishte miratur Ligjin për Sigurim Shëndetësor, i cili bazohej në modelin e Bismarck-ut, që nënkupton se punonjësi edhe punëdhënësi do ta financojnë së bashku fondin shëndetësor, i cili pastaj do të shërbej për mbulimin e trajtimit për të gjithë të siguruarit dhe familjet e tyre, pa pagesa shtesë nga xhepat e përdoruesve.[127] Megjithëse ky model është shumë më i mangët se sa garanca e kujdesit univerzal shëndetësor, ai megjithatë paraqet një avancim të rëndësishëm krahasuar me gjendjen aktuale.

Fatkeqësisht, lancimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore u shty për 5 vjet rradhazi; asnjë qeveri nuk shfaqi vullnet për nisjen e mbledhjes së pagesave. Kjo do të perceptohej si rritje e taksave, veçanërisht para prodhimit të katalogut të ri të shërbimeve. Qeveria e kaluar këmbëngulte se sistemi s'mund të funksionalizohej pa një sistem digjital për administrimin e regjistrave mjekësor, meqë kjo bazë e të dhënave ishte e nevojshme për integrimin e qendrave publike në skemën që do të përfshinte secilin kontribues. Fakti që skemat e ngjashme, por pa mjete digjitale të menaxhimit, kanë ekzistuar për një shekull në gjithë Evropën, dhe se bazat e të dhënave digjitale aktualisht përdoren nga shumë korporata

[122] Sipas raportit të fundit, në vitin 2018 Oda e Mjekëve të Kosovës u ka lëshuar mejkeëve vendorë rreth 200 certifikata, të cilat ua lejonin atyre të punonin në profesion nëpër shtetet evropiane. Njëqind certifikata shtesë janë kërkuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2019. Shih Buletinin Ekonomik, *Mjekët dhe infermierët po ikin në Gjermani*, 27 tetor 2019, në http://buletiniekonomik.com/index.php/2019/10/27/mjeket-dhe-infermieret-po-ikin-ne-gjermani/

[123] Monitor, *Pagat u rritën në Kosovë për të frenuar ikjen e mjekëve në Gjermani*, 6 prill 2019, në https://www.monitor.al/pagat-u-rriten-per-te-frenuar-ikjen-e-mjekeve-ne-gjermani-2/

[124] Intervistë e Grupit për Ballkan, Intervistë grupore, tetor 2019

[125] Instituti i Kosovës për Demokraci, *KDI dhe katër institucione do të bashkëpunojnë për rritje të llogaridhënies dhe transparencës në prokurim publik,* Njoftim për shtyp, Prishrtinë, 3 tetor 2018, në http://kdi-kosova.org/en/activities/ kdi-dhe-kater-institucione-do-te-bashkepunojne-per-rritje-te-llogaridhenies-dhe-transparences-ne-prokurim-publik/

[126] Ministria e Shnëdetësisë, *Ministri Ismaili nënshkroi Listën e re të Barnave Esenciale*, Njoftim për shtyp, Prishtinë, shtator 2019, në https://msh.rks-gov.net/ministri-ismaili-nenshkroi-listen-e-re-te-barnave-esenciale/

[127] Ligji për Sigurimin Shëndetësor (prill 2014)

private me institucione të shumta shëndetësore, duket se e dëshmon të kundërtën. Në të vërtetë, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021 e trajton gjerësisht procesin që shpie deri te një sigurim shëndetësor funksional, pa u marrë fare me digjitalizim.

Qeveria e re duhet të fokusohet në themelimin e skemës së sigurimeve shëndetësore dhe ta përfundojë riorganizimin e vonuar të sektorit të shëndetësisë publike. Brenda një periudhe afatgjate do të duhej të prezantohej tranzicioni drejt një Sistemi Kombëtar të Shëndetësisë, ndonëse ai do të duhej ndërtuar mbi një bazë të shëndoshë funksionale të sistemit. Në periudhë afatshkurtër, ndërkaq, Ministria e Shëndetësisë duhet të fillojë me veprime tashmë të parapara në Strategji, e të cilat nuk janë zbatuar asnjëherë. Paralelisht, ajo duhet të krijojë një grup punues ose një komision drejtues, i cili do ta ketë për detyrë avancimin e digjitalizimit të regjistrave mjekësorë dhe të bazave tjera të të dhënave menaxhuese. Ajo mund të mbështetet në përvojën e ministrive të tjera, si ajo e Punëve të Brendshme apo e Drejtësisë, ku digjitalizimi tashmë ka përfunduar.

REKOMANDIME:

- Kërkoni **mbështetje bilaterale** për zvhillimin e kapaciteteve dhe rritjen e shërbimeve, zbatoni marrëveshjet e arritura tashmë dhe zhvilloni programe të reja të trajnimeve;
- Themeloni një **komision të pavarur shqyrtues**, me qëllim të vlerësimit të **performancës** së institucioneve shëndetësore, dhe për identifikimin e të metave, nevojave dhe veprimeve të domosdoshme për përmirësim e shërbimeve, kërkoni ndihmën e partnerëve kredibil ndërkombëtarë.
- Vendosni dhe zbatoni një **kalendar përfundimtar** për aplikimin e skemës së **sigurimeve shëndetësore**. Ai duhet të fillojë me **mbledhjen e premiumit** dhe **katalogun e shërbimeve** që do të ofrohen;
- Vendosni një grup punues apo një **komision drejtues** për **digjitalizimin e shërbimeve shëndetësore** brenda ministrisë, duke u bazuar në përvojat e mëhershme të ministrive tjera;
- Përmirësoni **kushtet e punës** për profesionistët shëndetësorë, me qëllim të uljes së **largimit të ekspertëve** drejt Gjermanisë dhe vendeve tjera të Evropës;

MJEDISI

Qasja ndaj mjedisit dhe trajtimi i mbeturinave

Shqetësimet për mjedisin po bëhen pothuajse të zakonshme në ligjërimin publik, jo vetëm ndërkombëtarisht, por edhe brenda vendit. Tradicionalisht, çështjet mjedisore në Kosovë kanë prirje që të anashkalohen nga institucionet, prandaj shumë çështje mbesin të pazgjidhura; prerja ilegale e pyjeve dhe ndërtimet pa leje, toka e ndotur, lumenjtë e ndotur dhe shkarkimi i ujërave të zeza dhe i mbeturinave të ngurta.[128] Ministria e Mjedisit konsiderohet pothuajse nga të gjithë si joefikase dhe e zhytur në korrupsion. Gjendja e mjedisit ndryshon fare pak, përkundër shpenzimit të miliona eurove nga taksat dhe nga paratë e donatorëve. Posti i ministrit vazhdmisht i është dhënë partive të vogla brenda koalicionit, si shenjë "faleminderimi" për mbështetjen e tyre.[129] Ligjet për mbrojtjen e mjedisit, të fuqizuara edhe me kodin e ri penal, pothuajse nuk zbatohen, ndërkaq shkelësit e tyre mbesin të pandëshkuar.[130] Inspektorati Mjedisor ka vetëm 31 persona.[131] Prokurorët dhe gjykatat nuk janë të trajnuar për dispozitat brenda kodit të ri penal në lidhje me mbrojtjen e ambientit, dhe kjo e bënë të vështirë shqiptimin e dënimeve.[132] Qeveritë e mëhershme kanë publikuar plane të ndryshme nacionale të veprimit, strategji, madje edhe plane të veprimit, por kanë dështuar tërësisht që të veprojnë ndaj këtyre çështjeve. Në ndërkohë, mjedisi vazhdon të degradohet.

Në këtë kuptim, çështjet kryesore mjedisore ndërlidhen me projektin enorm të ndërtimit të termocentralit të ri me thëngjill, Kosova C apo Kosova e Re, për ta zëvendësuar Termocentralin A të vjetruar (e cili ka degraduar tashmë) dhe për të mbështetur Kosovën B (e cila ka nevojë të modernizohet ndjeshëm). Në tetor të vitit 2018, Banka Botërore u tërhoq nga mbështetja e këtij projekti, megjithëse kishte premtuar fillimisht.[133] Qeveria Haradinaj vendosi të vazhdojë vet me zhvillimin e projektit, me pretekstin se termocentrali super-modern do të jetë shumë më i pastër se Kosova A e vjetruar. Strategjia e Energjisë 2017-2026 e parasheh linjitin si burim kryesor të energjisë për një të ardhme të parashikueshme.[134] Ajo gjykon se thëngjilli është e vetmja mënyrë e sigurt dhe e përballueshme për garantimin e furnizimit me energji elektrike, ngase Kosova nuk ka burime tjera, e as nuk është e lidhur me rrjetet evropiane të gazit, përderisa energjia bërthamore, e cila i tejkaloan mundësitë e shtetit, as që mund të konsiderohet. Rrjedhimisht, thëngjilli mbetet burimi i vetëm që mund ta garantojë prodhimin bazë. Por, strategjia po ashtu thekson edhe rolin e burimeve të enegjisë së ripërtritëshme si një përzierje shtesë e furnizimit me energji, në përputhje me trendin e përhapur evropian.

---

[128] Qendra Informative dhe Kulturore e BE-së, *Mjedis i gjelbër do të thotë: Ujë i pastër, mjedis pa mbeturina, energji e gjelbër, ajër kualitativ [Green Environment Means: Clean Ëater, Waste Free, Green Energy, Air Quality]*, Prishtinë, dhjetor 2018, në https://europehouse-kosovo.com/wp-content/uploads/2018/12/EUICC_ENVI_publication_eng12-1.pdf

[129] Nga viti 2008 deri më 2019 një 'partner i vogël' ishte gjithmonë përgjegjës për ministrinë: Mahir Yagcilar – Partia Demokratike Turke e Kosovës (PDTK), 2011-2014; Dardan Gashi – AKR-Lista Rugova, 2014-2016; Ferid Agani – Partia e Drejtësisë (PD), 2016-2017; Ferat Shala – PDK, 2017-2018; Albena Reshitaj dhe Fatmir Matoshi - AKR, 2018-2019

[130] Komisioni Evropian, *Kosovo* 2019 Report*, 2019, f.78

[131] Sipas strukturës aktuale të Ministrisë së Mjedisit (dhjetor 2019), ky funksion i takon Departmentit të Inspektimit Mjedisor, Ujit, Ndërtimit dhe Planifikimit, në https://mmph.rks-gov.net/al/departamentet/318/misioni-vizioni-dhe-detyra

[132] Komisioni Evropian, *Kosovo* 2019 Report*, 29 maj 2019, f.78

[133] Një përmbledhje e të gjitha iniciativave të ndërmarra nga Banka Botërore sa i përket energjisë në Kosovë mund të gjendet në uebfaqen e saj, në https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/brief/energy-in-kosovo

[134] Ministria e Zhvillimit Ekonomik, *Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017–2026*, Prishtinë, mars 2017, f. 36, në http://mzhe-ks.net/repository/docs/Kosovo_Energy_Strategy.pdf

Strategjia e përcakton si objektiv arritjen e kursimit të përgjithshëm të energjisë në nivel prej 9 përqind, ndërkohë që pretendon rritjen e pjesës së burimeve të energjisë së ripërtritshme deri në 25 përqind të konsumit të energjisë bruto, deri në vitin 2020.[135] Për ta arritur këtë, ajo parasheh një skemë tarifore të energjisë nga hidrocentralet, centralet me energji të erës, të diellit, dhe të biomasës. Skema bazohet në marrëveshjet afatgjata me prodhuesit e energjisë, që garantojnë se rrjeti do të blejë çfarëdo energjie që mund të sigurohet me një normë fikse dhe për një periudhë të caktuar kohore.[136] Mirëpo, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), e cila është e ngarkuar me përcaktimin e tarifave, i ka bazuar ato në supozime joreale, gjë që ka rezultuar me shifra jashtëzakonisht të larta, të cilat konsumatorit përfundimtar do t'i kushtonin miliona euro. Kjo gjë pati ndikim në energji, veçanërisht në atë fotovoltaike, për të cilën tarifa e caktuar është mjaft zemërgjerë. Si rrjedhojë, përderisa një numër ndërmarrjesh kanë kërkuar licenca për ndërtimin dhe vënien në funksion të parqeve solare, ZRRE-ja ka hezituar t'i autorizojë ato, duke marrë parasysh efektin e tyre në çmimin përfundimtar.[137]

Nga ana tjetër, shtimi i burimeve të energjisë së ripërtritëshme është paraprirë nga hidrocentralet, të cilat po ashtu krijuan disa probleme. Vendi, sikurse edhe shumica e shteteve të Ballkanit Perëndimor, nuk ka lumenj të mëdhenj, andaj është mbështetur në ndërtimin e hidrocentraleve të vogla, shpeshherë të financuara me ndihma evropiane. Kontributi i përgjithshëm i këtyre impianteve në tregun e energjisë elektrike është i ulët, por efektet në mjedis nuk ndryshojnë nga ai i digave të mëdha.[138] Në Kosovë, këto projekte kanë nxitur protesta të shumta të komuniteteve lokale, të cilat janë ankuar se vlerësimet mjedisore nuk ishin serioze dhe se efektet afatgjata të këtyre impianteve janë në kundërshtim me pretendimet për çfarëdo përfitimi nga energjia "e gjelbër" që do ta prodhojnë.[139] Kjo ishte një çështje shumë diksutabile, por qeveria e kaluar dështoi të artikulonte një përgjigje të saktë lidhur me këtë çështje, gjë që tani do t'i takojë qeverisë së ardhshme.

Të gjitha këto çështje dëshmojnë për një të metë të projektit, që ka parandaluar çfarëdo tranzicioni të energjisë, pasi që 90 përqind e tregut elektrik mbetet i varur nga thëngjilli.[140] ZRRE-ja duket se është në dijeni të kësaj gjëje, prandaj ajo në fakt edhe e kishte lancuar një proces konsultimi me qëllim të uljes së konsiderueshme të tarifës lehtësuese për energjinë fotovoltaike, megjithëse ky veprim nuk prodhoi asgjë[141] Më vonë gjatë vitit, qeveria njoftoi se po e shqyrtonte kalimin në një sistem ankandi për energjinë e ripërtritëshme, ku çmimi i energjisë do të hapej përmes ofertimit nga prodhues të ndryshëm. Ky ndryshim do ta ulëte ndjeshëm çmimin e energjisë, andaj edhe fitoi përkrahjen e Bankës Evropiane

[135] *Ibid*, f. 15

[136] Strategjia parasheh tarifat si në vijim: për hidrocentralet e vogla 67.3 €/MWh, for centralet me fuqi të erës 85 €/MWh, për centralet me fuqi të biomasës 71.3 €/MWh dhe për parqet solare – fotovoltaike 136.4 €/MWh

[137] Që ga korriku 2019 nuk është dhënë asnjë licencë për prodhim të rrymës nga parqet solare. Lista e licencave të lëshuara mund të shihet në Regjistin Publik të Licencave, në uefaqen e ZRRE-së, në http://ero-ks.org/2019/Autorizimet_Licencat/2019_07_20_Rexhistri_mbi_Licencat_e_leshuara_eng.pdf

[138] Një studim i dhjetorit 2017 njoftoi se projektet e ngjashme në Shqipëri, Kroaci dhe Maqedoni kishin një ndikim substancial në ekosistemet lokale, shpeshherë duke i afektuar edhe zonat e mbrojtura, pasi që, në rastet më të shpeshta, e tejkalonin impaktin e përciptë mjedisor. Shih CEE Bankwatch Network, *Broken Rivers, Ndikimi i hidrocentraleve të vogla,* të financuara *nga Evropa,* në peizazhet e pa*prekura të Ballkanit [The impacts of European-financed small hydropower plants on pristine Balkan landscapes]*, dhjetor 2017, në https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2017/12/broken-rivers-bankwatch-study-on-hydropower-in-the-balkans-merged.pdf

[139] Reuters, *Fshati i ndarë malor i Kosovës bashkohet* për t*a luftuar hidrocentralin [Divided Kosovo mountain village unites to fight hydropower plant]*, 11 tetor 2019, në https://www.reuters.com/article/us-kosovo-environment-protest/divided-kosovo-mountain-village-unites-to-fight-hydropower-plant-idUSKBN1WQ21H

[140] Operatori Kosovoar i Sistemit Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), *Kapacitetet e Instaluara Prodhuese*, Prishtinë, 2019, në http://www.kostt.com/website/images/stories/parashikimingarkeses/INSTALLED_GENERATION_CAPACITY.docx

[141] Zyra e Rregullatorit të Energjisë, *Fletë-konsulta shënjestron mekanizmin e synimeve të BRE-së (fotovolatik diellore prej 20 MW) [Consultation Paper RES Targets Support Mechanism (20 MË solar photovoltaic)]*, Prishtinë, maj 2019, në https://www.ero-ks.org/2019/Tarifat/Consultation%20Paper-%20RES%20Targets%20Support%20Mechanism.pdf

për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).[142]

Përderisa të mos ndodh ky "tranzicion" i energjisë, niveli degradues i ajrit shkaku i ndotjes së rëndë vazhdon t'i shqetësojë banorët e Prishtinës për vite me radhë. Lajmi se Kosova ka numrin më të lartë të vdekjeve në Evropë shkaku i ndotjes së ajrit, shpërtheu gjatë fushatës.[143] Monitorimi i kualitetit të ajrit është rritur, megjithëse ende nuk ka ndonjë përpjekje madhore për uljen e këtij fenomeni.[144] Përderisa shkarkimi i gazrave nga veturat e vjetra dhe përdorimi i thëngjillit për ngrohje nga amvisëritë përbëjnë problem të madh, Kosova A dhe B mbesin faktorët kryesorë, të paktën për Prishtinën dhe rrethinën e saj.[145]

Gjithashtu, problem të madh paraqesin edhe mbeturinat urbane. Në letër, korniza ligjore duket gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me *acquis*, dhe madje i parasheh parimet "ndotësit paguajnë" dhe "përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit".[146] Po ashtu, Ligji shfaq një katalog gjithëpërfshirës të llojit të mbeturinave, ndërsa disa nga rregulloret definojnë tutje se si duhet të trajtohet secili lloj para depozitimit përfundimtar. Në praktikë, trajtimi i mbeturinave (qofshin ato urbane, industriale apo mjekësore) nuk bëhet, por ato vetëm groposen apo hidhen në deponi të hapura, një proces ky i lirë që nuk kërkon investime të mëdha.[147] Cilido lloj i riciklimit që bëhet, bëhet në mënyrë joformale nga agjentë të paregjistruar dhe jo të rregulltë, që kryesisht iu përkasin komuniteteve të margjinalizuara.[148] Për më tepër, zinxhiri menaxhues është tepër i komplikuar, ngase mbledhja varet nga ndërmarrjet publike komunale apo rajonale, ndërkohë që deponitë menaxhohen nga një kompani publike nacionale. Për më tepër, akterët privatë mund të marrin pjesë në secilën fazë, po që se janë të licencuar nga Ministria e Mjedisit.[149] Në teori, komunat mund ti financojnë këto shërbime përmes mbledhjes së tarifave nga familjet dhe bizneset, mirëpo për shkak të kapacitetit përgjithësisht të ulët të mbledhjes, ato janë munduar që vet t'i mbulojnë shpenzimet aktuale. Në vitin 2018, të mbuluara me shërbime ishin më pak se 60 përqind e popullsisë, ndërkohë që niveli i inkasimit të pagesave lëvizte mes 60 dhe 80 përqind, varësisht nga kriteret. Njëkohësisht, janë regjistruar 1572 deponi të palicencuara ku hidhen mbeturinat.[150]

---

[142] Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, *Mështetja e implemntimit të ankandit të energjisë së ripërtritëshme në Kosovë [Support for the Implementation of Reneëable Energy Auctions in Kosovo],* TCRS 11932, Londër, 22 gusht 2019, në https://www.ebrd.com/work-with-us/projects/tcpsd/support-for-the-implementation-of-renewable-energy-auctions-in-kosovo.html

[143] Koha Ditore, *Kosova e para në Evropë për numrin e vdekjeve nga ajri i ndotur, partitë nuk ofrojnë zgjidhje*, 30 shtator 2019, në https://www.koha.net/video/186536/kosova-e-para-ne-evrope-per-numrin-e-vdekjeve-nga-ajri-i-ndotur-partite-nuk-ofrojne-zgjidhje/

[144] Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës drejton një rrjet prej 9 stacioneve përgjatë tërë vendit, përderisa Ambasada e SHBA ishte institucioni i parë që filloi matjen e kualitetit të ajrit nga selia e saj në kryeqytet. Për më shumë informata shih Pristina Insight, *Pikat e dobëta* **në hartë: Ndotja e ajritë Kosovë** *dhe shkaqet e saj [The Vulnerable Points on the Map: Kosovo's Air Pollution and Causes]*, 14 mars 2019, në https://prishtinainsight.com/the-vulnerable-points-on-the-map-kosovos-air-pollution-and-its-causes/. Masat e ndërmarra përfshijnë ndalimin e ngrohjes me thëngjill nëpër institucione publike dhe të ngasjes së automjeteve në qendër të qytetit, Koha Ditore, *Partitë garuese në zgjedhje e lënë në harresë ajrin e ndotur në Kosovë*, 26 shtator 2019, në https://www.koha.net/zgjedhjet-2019/185990/partite-garuese-ne-zgjedhje-e-lene-ne-harrese-ajrin-e-ndotur-ne-kosove/

[145] Centralet elektrike (Kosovo A dhe B), automjetet e shumta të vjetra, përdorimi i thëngjillit për ngrohje, dhe menaxhimi jo i duhur i mbeturinave konsiderohen burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Kosovë.

[146] OECD e definon si parim atë se "ndotësi paguan", sipas të cilit personi që e shkakton ndotjen bartë edhe shpenzimet për uljen saj. "Përgjegjëia e zgjeruar e prodhuesit", nga ana tjetër, nënkupton se prodhuesi i çfarëdo malli, në parim, është përgjegjës për ciklin jetësor të produktit edhe pas konsumimit të tij nga përdoruesi fundor, duke marrë kështu përsipër barrën e institucioneve publike. Të dy parimet, megjithëse formalisht janë në fuqi në Kosovë pothuajse nuk respektohen fare në praktikë.

[147] Instituti për Zhvillimin e Politikave, *Menaxhimi Mbeturinave në Kosovë: Identifikimi i sfidave në këtë sektor*, maj 2018, f.19

[148] *Ibid*, f. 26

[149] Më herët licencimi varej nga komunat, por që nga riorganizimi i ministrisë, në qershor 2017, përmes Rregullores 05/2017 është përcaktuar qartë se kjo kompetencë është ricentralizuar.

[150] Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, *Menaxhimi i Mbeturinave në Komunat e Kosovës, Status Raport,* Prishtinë, maj 2018, f. 43, në https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Municipal_Waste_Managment_in_Kosovo_2018.pdf

Qeveria e re duhet ta ndryshojë plotësisht qasjen krahasur me paraardhëset e saj. Mjedisi duhet të bëhet prioritet, në vend se të mbetet një departament i parëndësishëm që iu jepet partnerëve të vegjël. Politikat e mjedisit duhet të zgjerohen ashtu që publiku të përfshihet dhe edukohet mbi dëmet që veprimet individuale mund tëia shkaktojnë mjedisit, por edhe që qytetarët të ndërgjegjësohet se duhet ndryshuar. Tranzicioni i energjisë duhet të përshpejtohet, ndërkohë që çështja e ndërtimit ose jo i Kosovës së Re të vendoset pas një shqyrtimi publik të fakteve. Kjo do të thotë se, nevojitet një rritje e transparencës me të cilën është zhvilluar i gjithë procesi deri më tani, si dhe publikimi i informacioneve përkatëse rreth kushteve të projektit dhe kontratave përkatëse. Veç kësaj, Mjedisi dhe Zhvillimi Ekonomik (ose pasardhësja e saj) duhet të koordinohen për t'i dhënë prioritet tranzicionit drejt një sistemi të ankandit për energjinë e ripërtritëshme, meqë skema aktuale e tarifave lehtësuese më tepër po funksionon si pengesë se sa si mjet promovimi.

Njëkohësisht, Ministria e Mjedisit duhet ta përfundojë reformimin e saj dhe t'i rrisë kapacitetet e saj administrative dhe inspektuese. Ajo duhet të lëvizë përtej monitorimit të kualitetit të ajrit dhe t'i fuqizojë masat tashmë të parashikuara, siç janë promovimi i sistemeve më efikase të ngrohjes dhe sanksionimi i përdorimit të karburantit të cilësisë së dobët. Po ashtu, ajo duhet t'i mbyllë deponitë e paligjshme, t'i sanksionojë aktivitetet e paregjistruara që e dëmtojnë mjedisin dhe të sigurohet që akterët publik dhe privat të respektojnë rregulloren ekzistuese për mbeturinat ubane, duke i mbështetur komunat në mbledhjen e pagesave. Bashkë me Ministrinë e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, nga ana e saj, duhet ta fuqizojë mbikëqyrjen e ndërmarrjeve të ndryshme publike, të cilat ndërhyjnë në zinxhirin e administrimit të mbeturinave; praktikat e tilla joadekuate, bashkë me mosfunksionimin e brendshëm, kanë rezultuar me pasoja afatgjata për mjedisin dhe për shëndetin e popullatën.

REKOMANDIME:

- Zgjeroni konsultimet dhe diskutimet publike rreth të ardhmes së **prodhimit të energjisë**, të **mbylljet** Kosova A, sa më shpejtë që të jëtë e mundur, dhe të bëhet rinovimi pa vonesë i Kosovës B. Nëse duhet të ndërtohet Kosova C, kjo duhet të bëhet duke minimizuar efektet mjedisore në përputhje me **specifikat më të larta evropiane**;
- Rivlerësoni performancën dhe strukturën e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Pas ristrukturimit, **Ministria e Zhvillimit Ekonomik** duhet ta mbështesë ZRE-në, në procesin e kalimin në treg të energjisë përmes **sistemit të ankandit**;
- Bëni një vlerësim të plotë të nevojave dhe një rishikim funksional, me qëllim të riorganizimt të **Ministrisë së Mjedisit**; zyrtarët kryesorë dhe zyrat e caktuara duhet të hetohen dhe të ristrukturohen. Struktura e re duhet ta ketë prioritet integrimin dhe fuzionimin e poltikave për mbrojtjen e ambientit. Ministria duhetet ta rrisë **numrin e inspektorëve** dhe t'i sanksionojë shkeljet ligjore.
- Loboni për anëtarësim apo, së paku, kërkoni mbështetje nga **organizatat ndërkombëtare të specializuara në çështjet e mjedisit**; si psh nga Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike, ose Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, në mënyrë që Kosova të përafrohet me **Marrëveshjen e Parisit për klimën**.
- Në koordinim me **Akademinë e Drejtësisë**, bëni çështjet e mbrojtjes së ambientit pjesë të trajnimeve për prokurorë dhe gjykatës. Ngjashëm me **Akademinë e Kosovës për Siguri Publike** oficerët policorë duhet të trajnohen për çështje mjedisore;
- **Ministria e Arsimit** duhet ta përfshijë mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin në kurrikulën e arsimit, në mënyrë që të ndryshohet qasja shoqërore ndaj ambientit;
- Të mbikëqyret performanca e komunave në çështjet mjedisore, të fuqizohet **baza ligjore** dhe të vendosen mekanizma shtesë për **inkasimin e pagesave**, që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave urbane, si dhe të mbështeten komunat për zgjerimin e mbulimit të shërbimeve. Të lehtësohet krijimi i **ndërmarrjeve publike komunale** në komunat e pakënaqura me strukturën ekzistuese të rajonalizuar;
- Në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe atë të Zhvillimit Ekonomik, të **hartohen protokolet** dhe të definohen vijat e përgjegjësisë për menaxhimin e mbeturinave **industriale dhe mjekësore**.

EKOMOMIA DHE ZHVILLIMI

Eliminimi i rrjedhjeve dhe riorganizimi i agjencive dhe i aseteve

Gjendja e ekonomisë mbetet shqetësuese. Edhe pse gjatë dekadës së fundit Kosova ka shënuar rritje të vazhdueshme, efektet e kësaj rritjeje nuk janë të qëndrueshme.[151] E bazuar së tepërmi në shërbime dhe në shpenzime publike, rritja ekonomike nuk ka rezultuar me rritjen e standardin e jetës. Sipas një ankete për matjen e opinionit publik, të realizuar nga UNDP, papunësia, varfëria dhe korrupsioni mbeten në vazhdimësi problemet më të mëdha për kosovarët.[152]

Treguesit makro-ekonomik mbesin të tmerrshëm; papunësia është e lartë, dhe në vitin 2018 ishte 29.6 përqind, ndërsa niveli i pasivitetit (i cili matë numrin e njerëzve që s'janë të punësuar, por që fare nuk kërkojnë punë, prandaj edhe s'mund të llogariten si të papunë) është edhe më i lartë, dhe shkon në 59.1 përqind. Kjo do të thotë se raporti punësim-popullësi është jashtëzakonisht i ulët, dhe mezi arrin 28.8 përqind.[153] Me fjalë të tjera, në çdo 10 kosovarë të gatshëm për punë, të punësuar janë vetëm 3. Sipas Agjencisë së Statistikave, paga mesatare bruto për këta të punësuar është 6,696 euro (mujore 588 euro), që i bie më pak se një e gjashta e mesatares së OECD-së, prej 42,476 eurove (ose 46,686 dollarë).[154] E gjithë kjo situatë i kontribuon një popullate të varfër, gati një e treta e së cilës ndodhet nën kufirin e varfërisë.[155] E për ta përkeqësuar situatën edhe më tepër, disa raporte sugjerojnë se ekonomia joformale mund të shkojë në rreth një të tretën e prodhimit bruto të përgjithshëm (PBB-së) së vendit.[156]

Edhe pse skemat e ndihmës sociale ekzistojnë për të mbështetur popullatën më të varfër, duket se ndihma financiare arrin vetëm deri tek 34 përqind e atyre që konsiderohen se vuajnë nga varfëria e skajshme. [157] Jo vetëm që ekzistojnë zbraztësira të konsiderueshme, sikurse mungesa e subvencionimit të papunësisë, por edhe kriteret shumë të kufizuara, vetëm sa e zvogëlojnë ndjeshëm përfitimin dhe mundësinë e përdorimit të skemave të ndryshme sociale. Këto politika duhet të rishikohen dhe të reformohen përfundimisht, për të rritur grupin e përfituesve dhe nxitjen e kërkimit të punësimit.[158]

---

[151] Sipas shifrave të Bankës Botërore, nga viti 2011 e deri më 2018 ekonomia është rritur për çdo vit diku mes 4.81 përqind (2011) dhe 1.12 përqind (më 2014), rrjedhimisht është shmangur skenari i keq i Recesionit të Madh. Në fakt, që nga shpallja e pavarësisë, në vitin 2008, Kosova kurrë nuk ka qenë në recesion. Statistikat mund të shihen në https://data.worldbank.org/indicator/ NY.GDP.MKTP.KD.ZG?locations=XK

[152] UNDP në Kosovë, *Pulsi publik VX [Public Pulse VX]*, United Nations Development Programme, Prishtinë, shkurt 2019, f. 13, në https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-xv/

[153] Të dhënat e plota statistikore mund të konsultohen në uebfaqen e Agjencisë së Kosovës për Statistika, në http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/askdata__Labour%20market__02%20Annual%20labour%20market/lfs03.px/table/tableViewLayout1/?rxid=c3e44c2e-1aff-4e4a-b55b-2ca64a485a50

[154] Të dhënat mund të konsultohen në uebfaqen e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, në https://data.oecd.org/earnwage/average-wages.htm

[155] Bertelsmann Stiftung, *BRI 208 – Raporti shtetëror për Kosovën* [*BTI 2018 Country Report Kosovo]*, 2018, f. 18

[156] Prishtina Insight, *Ekonomia joformale: djalli mbi krihët e Kosovës* [*Informal economy: the devil on Kosovo's shoulder]*, 25 qershor 2019, në https://prishtinainsight.com/informal-economy-the-devil-on-kosovos-shoulder/

[157] Sipas Rrjetit të Arsimit dhe Punësimit të Kosovës, vetëm 34 përqind e njerëzve që jetojnë me më pak se 1.82 euro në ditë janë të mbuluar me skemën e asistencës sociale. Shih KEEN, *Punësimi dhe Politikat e Mirëqenies Sociale në Kosovë: Një vlerësim [Employment and Social Welfare Policies in Kosovo: An Assessment]*, f.. 72, dhjetor 2017, në http://www.keen-ks.net/site/assets/files/1406/assessment_report_on_ employment_and_social_welfare_policies_in_kosovo.pdf

[158] Për shembull, një amvisëri, një anëtar i së cilës kohë pas kohe kryen një punë zyrtare, nuk është më i përshtatshëm për Skemën e Asistencës Sociale, megjithëse ai mund të jetë nën kufirin e varfërisë. Kjo pastaj krijon dekurajim për gjetjen e çfarëdo lloji të punës, dhe i shtynë grupet e margjinalizuara drejt ekonomisë informale. Shih Grupi i Bankës Botërore, *Studim i vlerësimit të skemës për ndihmë sociale dhe i opsioneve të reformës në Kosovë [Kosovo Social Assistance Scheme Study Assessment and Reform Options],* mars 2019, në http://documents.worldbank.org/curated/__en/994991557470271998/pdf/Kosovo-Social-Assistance-Scheme-Study-Assessment-and-Reform-Options.pdf

Sistemi pensional ka veçanërisht të meta, sepse është joefikas dhe i paaftë për të përmbushur qëllimet e tij. Ai është i dizajnaur që të sigurojë se të gjithë të moshuarit marrin "diçka" (një pagesë minimale fillestare), mirëpo forma e tij aktuale mezi garanton ca pagesa të ulta mujore.[159] Për t'i mbuluar ato, janë zhvilluar disa skema të veçanta për grupe të caktuara përfituesisht, të cilat kanë rritur susbtancialisht shpenzimet e pensioneve, dhe e kanë 'fragmentuar' njëkohësisht sistemin pensional. Në vitin 2019, Buxheti i Shtetit ndau më shumë se 300 milionë euro për pensione, të financuara nga taksat.[160] Për të siguruar qëndrueshmëri afatgjate të sistemit, në fund të vitit 2018, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale propozoi një reformë të plotë. [161] Sipas strukturës së propozuar pensioni themelor i financuar nga shteti do të bëhej një rrjet i sigurisë, përderisa kontributet e punës do të ishin bazë e skemës pensionale, në përputhje me parimin 'Pay-as-you-go'.[162] Kjo gjë mund të sigurojë një qëndrueshmëri afatgjate, të garantojë pensione më të larta për pensionistët aktualë dhe të ardhshëm, dhe potencialisht të inkurajojë inkuadrimin e mijëra punonjësve nga ekonomia informale në sistemin e rregullt të kontratave.[163]

Sistemi i coptëzuar aktual, i bazuar në skema të ndryshme të posaçme nxit mashtrime. Një shembull jashtëzakonisht i keq është rasti i skemës së pensioneve për veteranë, e cila në teori duhet t'i shpërblejë ata që gjatë konfliktit ishin pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mirëpo, komisioni për verifikimin e statusit të veteranit (rrjedhimisht, i pranueshmërisë), me gjasë ka keqpërdorur varfërinë e tyre për të siguruar pensione për simpatizantë dhe miq, gjë që ka rezultuar me rritje enorme të numrit të përfituesve, ndoshta për tri herë. Qeveria fillimisht parashikonte një shpenzim maksimal vjetor prej 0.7 përqind të PBB-së, që në praktikë i buxhetoi 58 milionë euro për vitin 2019, por në fakt ajo shpenzoi më shumë se 70 milionë euro (pa përfshirë muajin dhjetor).[164] Prokuroria e Shtetit beson se rreth 19,000 persona po marrin pensione padrejtësisht, kështu që disa raste gjyqësore tashmë veç kanë filuar. Qeveria e kaluar minimizoi këtë çështje, për shkak të numrit të njerëzve të përfshirë, por qeveria e re nuk mund t'ia lejojë vetes një gjë të tillë. Përderisa proceset penale do të vazhdojnë me ritmin e vet, ministria mund të ushtrojë autoritetin e saj administrativ; ajo duhet të krijojë menjëherë një mekanizëm verifikimi për të rivlerësuar pranueshmërinë e secilit emër që figuron në listën e veteranëve, t'i ndalë pagesat për ata që nuk kualifikohen, të fillojë me veprime të menjëhershme juridike për kthimin e mjeteve të paguara tashmë, dhe t'i referohet prokurorit të shtetit për të nisur hetimet e tij për çdo shkelje të re të gjetur.

Për shtetin do të jetë e vështirë të gjejë burime për të financuar nismat e ndryshme tashmë të diskutuara, në të cilat në rastet më të shpeshta përputhen me premtimet elektorale të partive.

---

[159] Pensionet janë bazuar në tri kompenenta; E para, në tarifën fikse të pensionit për të gjithë qytetarët me moshë mbi 65 vjet, e kalkuluar në përputhje me koston e shportës minimale (75 euro në vitin 2018). E dyta, skema obliguese financohet nga kontributet e punës (10 përqind të pagës bruto), që kreditohet te punonjësi, dhe që pastaj paguhet si shumë e madhe e ndarë në pagesa mujore, derisa fondi të mos zbrazet. E treta, skemat e pensionit komplementar, të cilat nuk ekzistojnë në praktikë, meqenëse tregu për planet e pensioneve private nuk është zhvilluar kurrë.

[160] Ligji për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 ka ndarë 309,612,050 euro për 13 skemat ekzistuese pensionale, nga të cilat 140,087,706 euro i korrespondojnë pensioneve bazike. Që të gjitha financohen nga grantet e qeverisë.

[161] Procesi i konsultimeve për Reformën e Pensioneve mund të gjendet në http://konsultimet.rks-gov.net/_vieëConsult.php?ConsultationID=40517

[162] Sipas sistemit 'Pay-As-You-Go', kontributet nuk kursehen në fondet e investimeve, por ato dedikohen për pagesë të pensioneve të përfituesve aktualë. Shuma e lejuar kalkulohet në varësi nga mesatarja e pagës së pensionistit gjatë kohës sa ishte i angazhuar me punë. Ky model nuk e mbulon shumën që duhet paguar ndaj pensionistit, sikurse që është tani. Në vend të kësaj, sistemi garanton një pension të përcaktuar mujor deri në fund të jetës së pensionistit, meqë financohet nga punonjësit aktivë.

[163] Rrjeti Evropian për Politikë Sociale, *Kosova* po planifikon një ndryshim të rëndësishëm të politikës pensionale [Kosovo* Plans Significant Pension Policy Shift]*, ESPN Flash Report 2018/77, dhjetor 2018, në https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=20547&langId=en

[164] lajmi.net, *Largimet nuk e zvogëlojnë numrin e veteranëve – veç këtë vit u dhanë mbi 70 milionë euro për ta*, 6 dhjetor 2019, në https://lajmi.net/largimet-nuk-e-zvogelojne-numrin-e-veteraneve-vec-kete-vit-u-dhane-mbi-70-milione-euro-per-ta/

Sipas Agjencisë së Statistikave, për tremujorin e dytë të vitit 2019 shteti ka shpenzuar 120 milionë euro për mbrojtje sociale (24 përqind e hyrave të tij), përderisa tatimimi i drejtpërdrejtë ka shkuar në 82 milionë euro (75.4 milionë euro nga të ardhurat personale dhe 6.7 euro nga taksat në pronë). Arsimi mori 74,7 milionë euro shtesë, ndërsa Shëndetësia 51.1 milionë.[165] Megjithëse të hyrat doganore i kanë balancuar librat (ato përfaqësojnë më shumë se gjysmën e të ardhurave të shtetit), ekziston një dallim i madh në mes të hyrave edhe shpenzimeve sociale. Nëse qeveria e re e prezanton ndonjë program gjithëpërfshirës të reformës së një shteti të mirëfilltë social, asaj fillimisht do t'i duhet ta rrisë drastikisht aftësinë e mbledhjes së të hyrave, e pastaj të promovojë një rritje më të ekuilibruar. Thënë ndryshe, ajo duhet të krijojë pasuri në mënyrë që ta rishpërndajë atë. Kosova deri më tani ka bërë pak në krjimin e pasurisë, por edhe pak në rishpërndarjen e drejtë të saj. Shikuar në afat të gjatë, promovimi i sektorëve kryesorë nëpërmjet subvencioneve dhe lehtësimeve fiskale (duke pasur parasysh dhe respektuar rregullat e BE-së për subvencone shtetërore) dhe investimeve publike në shërbime dhe infrastrukturë, mund të ndihmojë në ri-ngritjen e ekonomisë. Mirëpo, në një afat të shkurtër investimet dhe ndërhyrjet e tilla do të jenë të kushtueshme, prandaj, për të qenë me fitim si shoqëri, ato duhet të ndjekin një analizë strikte të kostos-efektive, duke iu shmangur nismave të shtrenjta - kthimi i të cilave nuk është i sigurt. [166]

Shteti mund të sigurojë burime për financimin e këtyre aktiviteteve, duke lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi (Stand-By Agreement, SBA) me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN-në).[167] Përmes kësaj, shteti mund t'i qaset financimit të jashtëm me kushte të mira, por nën mbikëqyrjen e ngushtë të FMN-së. SBA e fundit është mbyllur në gusht 2017, pas tërheqjes së pak më shumë se 135 milionë eurove, 12 më pak se paketa e marrëveshjes financiare prej 147 milion Euro.[168] Qeveria Haradinaj nuk shfaqi interesim për ta vazhduar atë, e as për të kërkuar një marrëveshje të re. Meqenëse rëndësia e një SBA qëndron në një disciplinë të shtuar fiskale, preferohet që qeveria e re të kërkojë mbështetje nga FMN-ja, kudo që të ketë nevojë për financimin e programeve të saj.

Privatizimi mund të jetë një mekanizëm tjetër për të mbështetur rritjen, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e madhësisë së ekonomisë. Procesi i privatizimit po vazhdon për gati 20 vjet, por përfitimet e pritura nuk arritën të materializohen; pjesa më e madhe e privatizimeve ishin joefektive, të korruptuara dhe pa kontribut real në ekonomi. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka arritur t'i nxjerrë në ankand më shumë se 500 ndërmarrje shoqërore (NSH), kryesisht nëpërmes qasjes spin-off (që konsiston në krijimin e një kompanie te re, e cila i trashëgon pasuritë e NSH-së, por jo edhe detyrimet e saj, dhe pastaj bëhet shitja e ndërmarrjes së re), mirëpo në shumicën e rasteve këto ndërmarrje nuk kanë qenë të suksesshme në treg. Tani, në fund të vitit 2019, AKP-ja ende administron mbi 2000 prona të pashitura.[169] Në vitin 2018, Qeveria Haradinaj filloi me transferimin e madh të pronave të pashitura të AKP-së tek komunat, duke u arsyetuar se atyre iu duheshin këto pasuri për të nxitur interesin publik. Në praktikë, kjo nënkupton zvogëlimin e fushëveprimit të privatizimit, pasi që asetet do të mund të mbeteshin publike.

---

[165] Të dhënat e plota statistikore mund të konsultohen në uebfaqen e Agjencisë së Kosovës për Statistika.

[166] Prishtina Insight, *Një autostradë një- miliardë dollarëshe: rrugët më të shpejta, njerëzit më të varfër [A one billion dollar highway: faster roads, poorer people*,] 6 korrik 2019, në https://prishtinainsight.com/a-one-billion-dollar-highway-faster-roads-poorer-people/

[167] SBA-të janë marrëveshje afatshkurtëra të financimit, të përmbyllura ndërmjet FMN-së dhe Shteteve Anëtare, për t'iu përgjigjur nevojave të menjëhershme të fondeve për nisma të caktuara. Kur shteti pajtohet rreth SBA-ve, ai merr pësipër rregullimin e politikave që prekin shkaqet që shkauan mungesën e fondeve. Në teori, një SBA është edhe instrument finacimi edhe një mjet për reform ekonomike.

[168] Shih Historinë e Marrëveshjeve të kreditimi për Kosovë, në uebfaqen e FMN-së, në https://www.imf.org/external/np/fin/tad/extarr2.aspx?memberKey1=555&date1key=2017-07-31

[169] Sipas AKP-së, që nga dhjetori 2019 ajo posedon 327 asete në Prizren, 514 në Prishtinë, 577 në Pejë, 371 në Mitrovicë dhe 219 në Gjilan, që gjithsejt bëjnë 2008. Lista e plotë është e qasshme në uefaqen e saj, në http://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,74

Por, këto transferime përfshinin edhe një numër pronash që tashmë ishin asgjësuar ose për të cilat tashmë ishin vendosur masa gjyqësore.[170] Presidenti i drgoi këto vendime në Gjykatën Kushtetuese, e cila refuzoi të merrej me çështjen.[171] Pas këtij rasti, legji ri e ndryshoi plotësisht procesin e transferimit të pronave drejt institucioneve lokale. Përderisa ligji i vjetër, që ishte në fuqi asokohe, parashihte një proces më të saktësuar për pasuritë e administruara nga AKP-ja, ligji i ri përfshin vetëm një procedurë të vetme për transferimin e pronave nga AKP-ja te komunat, me rregullore më pak specifika, të cilat qeverisë i ofrojnë dukshëm më tepër liri veprimi, ndërsa e kufizojnë rolin e AKP-së në proceset e tilla.

Ekziston një bindje e përgjithme se privatizimi shërbeu më tepër për pasurimin e personave të caktuar sesa që i kontribuoi zhvillimit të gjithëmbarshëm, ngase nga procesi jotransparent shpeshherë përfitonin 'miqtë', në ndërkohë që çfarëdo përfitimi tjetër nga procesi ka mbetur i ngrirë në një fond, pas asnjë kontribut për arkat e shtetit apo për zhvillim shoqëror. Përderisa partitë që do të udhëheqin pas zgjedhjeve bien dakord që privatizimi nuk i ka arritur qëllimet e veta, ato ndryshojnë sa i përket veprimeve që duhet t'i ndërmarrë qeveria e re. Megjithatë, qeveria e re duhet të përshpejtojë procesin, duke e bërë atë më të besueshëm, me qëllim të tërheqjes së investitorëve kredibil, dhe largimin e aseteve nga kontrolli i oligarkëve. Këtu po ashtu duhet përfshirë edhe kthimi i të gjitha pronave të uzurpuara, një dukuri kjo mjaft e përhapur, veçanërisht në zonat urbane. Po ashtu, toka dhe pronat e paprivatizuara bujqësore duhet t'iu transferohen komunave, të cilave iu duhen së tepërmi për thithjen investime të reja.

Kosova aktualisht ka koeficientin më të ulët të të hyrave në PBB-së të shtetit në Ballkanin Perëndimor (27 përqind) dhe koeficientin e dytë më të ulët të shpenzimeve (30.2 përqind), që mezi ia kalon Shqipërisë, e cila është përfshirë në një konsolidim të madh fiskal për të ulur borxhin e saj publik.[172] Administrata Tatimore (ATK) ka vepruar sipas Planit Strategjik 2015-2020, dhe ka arritur një sukses gjatë viteve të fundit. Nga viti 2016 e deri në vitin 2018 ka arritur t'i rrisë të hyrat nga taksat për më shumë se 18 përqind, nga 386 në 456 milionë euro.[173] ATK pret t'i mbledhë 516 milionë në vitin 2019. [174] Edhe pse ekziston një përmirësim, të hyrat janë ende shumë ulët krahasur me mundësitë dhe nevojat e shtetit.

Ekonomia joformale vazhdon të pengojë zhvillimin ekonomik. Nga taksat e papaguara për çdo vit, ajo kap shifrën mes dy dhe tre miliardë euro.[175] Me një ekonomi të përhapur joformale, qeveria dhe ATK kanë luftuar vazhdimisht, në përpjekje për të garantuar fiskalizimin e bizneseve.[176]

---

[170] Ndërmjet qershorit dhe nëntorit të vitit 2018, qevëria lëshoi rreth 20 vendime për transferim të aseteve drejt autoriteteve komunale. Pas kontroversave, ajo u tërhoq dhe suspendoi të gjitha trasnferet e dekretuara paraprakisht, dhe anuloi transferet e të gjitha pronave tashmë të shitura apo të bllokuara juridikisht. Pasi që ishte bërë kjo, nimsa u la anash dhe deri më tani nuk u ri-lancua më.

[171] Rezoluta mbi Papranueshmërinë, në rastin nr. K0181/18, Kërkesa për vlerësimin e konfliktit të paragjykuar ndërmjet kompetencave kushtetuese të presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, sikurse janë definuar përmes Nenit 113.3 (1) të Kushtetutës, lidhur me vendimin e qeverisë për transferimin e disa pronave në pronësi publike në përdorim ose në pronësi të komunave, Ref. nr. 1385/19, 1 korrik 2019

[172] Banka Botërore, *Rritja e pasigurisë [Rising Uncertainties]*, Raporti i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor Nr.16, Grupi i Bankës Botërore, Uashington DC, vjeshtë 2019, në https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report

[173] Administrata Tatimore e Kosovës, *Raporti vjetor mbi Administratën Tatimore të Kosovës, janar-dhjetor 2018,* Prishtinë, shkurt 2019, f. 19, at http://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2019/04/ENGRaportiVjetor2018.pdf

[174] Administrata Tatimore e Kosovës, *Plani Vjetor i Punës,* Prishtinë, shkurt 2019, f.6, në http://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2019/03/ENGPlaniPun%C3%ABs2019.pdf

[175] Rajoni Press , *2-3 miliardë humbje vjetore, Qeveria kapitullon me informalitetin*, 20 janar 2019, në https://rajonipress.com/2-3-miliarde-humbje-vjetore-qeveria-kapitullon-me-informalitetin/

[176] Fiskalizimi, në Ligjin Fiskal është plani i rregullave dhe regulloreve që synojnë luftimin e mashtrimit në shitje me pakicë, zakonisht duke kontrolluar përdorimin e arkës për regjistrimin e parave të gatshme, për t'u siguaruar se dyqanet dhe bizneset i raportojnë transaksionet tek autoritetet kompetente.

Në përpjekje për kufizimin e dëmit që i është shkaktuar konkurrencës së drejtë e të barabartë, ATK ka bërë regjistrimin e detyrueshëm të parave të gatshme për të gjitha bizneset, për të adresuar kështu evazionin fiskal.[177] Në teori, ky proces është gjithëpërfshirës dhe i vazhdueshëm, por në praktikë ekziston një mospërputhje e konsiderueshme mes numrit të bizneseve të regjistruara dhe aktive, dhe atyre të fiskalizuara; janë afro 160,000 biznese aktive në vend, ndërkohë që vetëm 30,000 kontrollohen në mënyrë efektive nga ATK.[178] Në këtë kontekst, ATK dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, e cila e kontrollon Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), duhet të bashkëpunojnë ngushtë në integrimin e bazave të të dhënave, për t'u siguruar që secili biznes i regjistruar të mbikëqyret nga ATK. Njëkohësisht, duhet të rriten dhe avancohen kapacitetet e inspektorateve përkatëse, për t'u siguruar që bizneset të cilat nuk i deklarojnë të hyrat t'i nënshtrohen kontrollit.

Thelbi i këtij problemi është legjislacioni për tatimet, i cili në shumë raste mbetet i vjetëruar, i paqartë dhe plot zbrazëtira, duke krijuar kështu hapësirë për të institucionalizuar ekonominë joformale. Qeveria e kaluar kishte filluar me modernizimin e kornizës fiskale. Kuvendi kaloi ligjet e reja mbi Tatimin në Pronë dhe mbi Tatimin e të Hyrave të Korporatave, dhe po shqyrtonte edhe dy të tjera, atë mbi Tatimin e të Ardhurave Personale dhe të Vlerës së Shtuar, por në kohën e shpërbërjes së Kuvendit të dyjat ndodheshin në faza të ndryshme.[179] Qeveria e re duhet t'i rimarrë këto projekte sapo ta ketë marrë detyrën, dhe t'i shtyjë përpara sa më shpejtë që të jetë e mundur, për të lehtësuar kështu mbledhjen e tatimeve.

Për më tepër, qeveria e kaluar kishte filluar edhe procesin e riorganizimit të tatimeve, doganave dhe akcizave, me qëllim që t'i rriste të hyrat e shtetit, siç kërkohet vazhdimisht nga Bashkimi Evropian.[180] Programi i saj legjislativ për vitin 2019 përfshinte edhe një Draft-ligj për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe një Draft-ligj për Agjencinë e Tatimeve dhe Doganave, i cili do t'i integronte Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganat në një organizatë tatimore të vetme.[181] Përderisa në fillim të vitit 2019, Ministria e Financave realizoi konsultime me qeverinë, ajo ende nuk e ka shtyrë përpara projektin në fjalë.[182] Përkundrazi, në dhjetor 2018, ajo ka hartuar dhe miratuar një Plan të ri Strategjik për Doganat për periudhën 2019-2023.[183]

Qeveria e re duhet ta përfundojë riorganizimin dhe konsolidimin e agjencive për mbledhjen e të hyrave, duke i dhënë prioritet krijimit të Agjencisë së Tatimeve dhe Doganave, e cila duhet të krijohet brenda vitit të ardhshëm. Ky proces lejon jo vetëm vlerësimin e nevojave të personelit të organizatës së re, por edhe hap rrugë për një vlerësim gjithëpërfshirës të performancës gjatë tranzicionit, duke siguruar kështu që agjencia e re jo vetëm të ketë më tepër burime në dispozicion, por edhe që ato të posedojnë kapacitete më të mëdha.

---

[177] Radio Evropa e Lire, *Ekonomia joformale në Kosovë, mbi 30 për qind*, 14 dhjetor 2019, në https://www.evropaelire.org/a/ekonomia-joformale-ne-kosove-/28918270.html

[178] Buletini Eknomik, *Prej 160,000 bizneseve të regjistruara në MTI, vetëm 30,000 i paguajnë tatim shtetit*, 28 prill 2019 http://buletiniekonomik.com/index.php/2019/04/28/prej-160-mije-bizneseve-te-regjistruara-ne-mti-vetem-30-mije-i-paguajne-tatim-shtetit/

[179] Draft-Ligji për Tatimet e të Hyrave Pesonale kaloi në leximin e dytë, në muajin janar, por nuk u adoptua kurrë, përderisa Draft-Ligji për Taksën mbi Vlerën e Shtuar e kaloi vetëm leximin e parë, në muajin maj.

[180] Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm, *Kosova dhe BE-ja diskutojnë tregtinë, doganat dhe* tatimimin *[Kosovo and EU discuss trade, customs and taxation]*, njoftim për shtyp, Bruksel, 14 qershor 2018, në https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/46553/kosovo-and-eu-discuss-trade-industry-customs-and-taxation_en

[181] Zyra e Kryeministrit, *Programi Legjislativ 2019*, Prishtinë, 11 prill 2019, në http://kryeministri-ks.net/ëp-content/uploads/2019/05/Programi-Legjislativ-2019_2.5.2019.pdf

[182] Rezultatet e konsultimit mund të qasen në http://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=40552

[183] Dogana e Kosovës, *Plani Strategjik 2019–2023*, Prishtinë, dhjetor 2018, në https://dogana.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2019/02/KC-Strategic-Plan-2019-2023.pdf

Për më tepër, qeveria e kaluar kishte lancuar edhe Programin e Reformës Ekonomike 2019-2023, i koordinuar mes Ministrisë së Financave dhe Zyrës së Kryeministrit, i cili parashikon 20 veprime prioritare në 8 fusha (secila nën përgjegjësinë e një ministrie të caktuar).[184] Këto veprime ndjekin një strategji gjithëpërfshirëse dhe e mbulojnë detajisht pjesën më të madhe të temave të diskutuara më sipër. E kompletuar me indikatorë për secilin veprim, zbatimi i suksesshëm i programit do të siguronte një rritje të qëndrueshme për vitet e ardhshme. Qeveria e re duhet ta marrë përsipër pronësinë mbi programin, gjë që përputhet mjeshtërisht me prioitetet e saj të definuara tashmë, dhe ta shpërndajë atë nëpër ministritë përgjegjëse për vlerësim. Ky veprim do të duhej ta lehtësojë transformimin e gjatë e të vonuar ekonomik dhe të sigurojë një qasje gjithëperfshirëse dhe mirë të planifikuar lidhur me reformat e ndryshme që synohen të arrihen.

REKOMANDIME:

- Targetoni **investimet strategjike**, për të përshpejtuar **rritjen ekonomike**, pas një analize të kujdesshme të **kostos-efektive**;
- Trajtoni me prioritet **reformën e pensioneve**, me qëllim të riorganizimit të skemave pensionale dhe kalimin drejt modelit 'Pay-as-you-go', duke ulur kështu barrën buxhetore për qeverinë;
- Rishikoni **listën e veteranëve të luftës**, për t'i pastruar listat dhe për të mos lejuar pagesat për personat që nuk e meritojnë. Mbështetni dhe ofroni dëshmi për hetimet e prokurorisë për këtë çështje;
- Angazhohuni për një **Marrëveshje Stand-by të re** me Fondin Monetar Ndërkombëtar, si burim i finacimit të jashtëm dhe i rritjes së **disciplinës fiskale** që marrëveshja sjell;
- Rioganizoni dhe përshpejtoni procesin e **privatizimit**, duke e bërë procesin më atraktiv për investitor kredibil dhe ktheni pronat e uzurpuara. Kufizoni transferin e pronave të pashitura shoqërore, duke u fokusuar në hapësirat dhe tokat bujqësore tek komunat, të cilat do t'i kotribuonin zhvillimit të ekonomisë lokale;
- Zgjeroni **kapacitetet e fiskalizimit** të ATK-së, duke siguruar mbulueshmëri të gjerë dhe pandërpreprë, më qëllim të **regjistrimit të qarkullimit të parasë.** Të rritet numri i inspektorëve dhe ngritja e **kapaciteteve** për ta, me fokus në luftimin e ekonomisë joformale;
- Trajtoni me prioritet përmbylljen e **Reformës Fiskale** dhe procedoni me **draft-ligjet** për **Tatimin në Pronë** dhe **Tatimin në të Ardhura të Korporatave**;
- Krijoni një Agjenci të vetme për mbledhjen e tatimeve, duke integruar **Administratën Tatimore dhe Doganat**, me mbështetje (dhe praktikat më të mira) të vendeve skandinave. Vendosni një sistem të "**kontrollit të integritetit**" për të gjithë zyrtarët të cilët transferohen në agjencinë e re;
- Mbështetni dhe implementoni **Programin e Reformave Ekonomike 2019-2023**, të hartuar nga qeveritë e kaluara.

[184] Qeverisa e Kosovës, *Programi i Reformës Ekonomike 2019–2021*, Prishtinë, janar 2019, në https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4FC-9C8D0-8ADF-4DD1-97B8-BB2DD36150C3.pdf

Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) është organizatë (Think Tank institute) e pavarur rajonale, me seli në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza të detajuara të politikave zhvillimore për një sërë çështjesh të ndërlidhura me shtet-ndërtimin, konsolidimin institucional e demokratik; integrimin e minoriteteve, dhe marrëdhënieve ndërshtetërore; si dhe integrimin evropian dhe reformat politike.

Ne kemi dekada përvojë në hartim, raportim dhe zhvillim të politikave, qasje strategjike dhe avokim tek qeveritë, institucionet ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare.

Në thelbin e punës sonë qëndrojnë raportimet tona të sakta, të detajuara dhe të paanshme, gjithmonë të bazuara në hulumtimet tona nga terreni. Ne shkojmë përtej qëndrimeve të etabluara dhe synojmë të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve për politika për të ardhmen e që janë kreative, të realizueshme dhe të matshme, duke kontribuar që vendet tona të zhvillojnë shoqëri dhe shtete të fuqishme demokratike, të qëndrueshme dhe të suksesshme bazuar në sundimin e ligjit.

Grupi për Ballkan ka dizajnuar edhe instrumente të reja për të arritur këtë ndryshim, siç janë: Dialogu Politik, Forumi Politik (Forum për Avokim i nivelit të lartë i organizatave Think Tank) dhe Forumi i Shoqërisë Civile për Bashkëpunim Ndërkufitar.

Norwegian Embassy